



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 24 regjistër (JR)
Datë 05.06.2023

Nr. 76 i vendimit
Datë 29.10.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 29.10.2025, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Arjela Vllaçaj, çështjen nr. 24/2023 (JR), datë 05.06.2023, që i përket:

ANKUES: Besnik Shehu, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 641, datë 06.04.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 42 dhe neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni F i Aneksit të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 1, 2, 62, 63, dhe 66, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në datën 29.10.2025, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 641, datë 06.04.2023, dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes, Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Besnik Shehu (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16, të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (në vijim “ILDKPKI”), Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), nga të cilat ka rezultuar se:
 - 2.1. ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me subjektin e rivlerësimit Besnik Shehu, ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurive; (iii) ka mosdeklarim ndër vite; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
 - 2.2. DSIK-ja, në përputhje me kërkesat e nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur pranë Komisionit raportin për subjektin e rivlerësimit Besnik Shehu, i deklasifikuar plotësisht, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.
 - 2.3. KLGj-ja ka dërguar në Komision raportin vlerësues për subjektin e rivlerësimit Besnik Shehu. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dosjeve, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor. Bazuar në kriteret e vlerësimit, sipas ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, referuar neneve 71-76, KLGj-ja ka analizuar lidhur me: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, si dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.
3. Bazuar në nenin 4, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLGj-ja, si më sipër, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Besnik Shehu,

bazuar vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke marrë në përfundim të procesit, vendimin nr. 641, datë 06.04.2023.

II. Vendimi i Komisionit

4. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ për kriterin e pasurisë, arriti në konkluzionin se provat për kriterin e pasurisë kanë nivelin e provueshmërisë, pasi subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave për krijimin e tyre, sipas përcaktimit në pikën 4, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për periudhën 1997 – 2016, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me një balancë negative në shumën (-) 8.489.894 (tetë milionë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, të cilat u vlerësuan të mjaftueshme për aplikimin e nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.
5. Përfundimet e mësipërme u vlerësuan të mjaftueshme nga Komisioni për të konkluduar lidhur me rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, mbështetur vetëm në kriterin e pasurisë, pasi çdo përfundim tjetër lidhur me vlerësimin e kritereve të tjera nuk do të mund ta çonte në një vlerësim të ndryshëm për zgjidhjen e çështjes.
6. Në konkluzion të sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe, me vendimin nr. 641, datë 06.04.2023, ka vendosur: *“Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Besnik Shehu, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë”*.

III. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me vendimin e KPK-së

7. Subjekti i rivlerësimit, në datën 25.05.2023, ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. 641, datë 06.04.2023, të Komisionit, duke kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”), ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmimin në detyrë. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin drejtuar Kolegjit, ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

- Pretendime për procesin e rregullt

8. Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankimin drejtuar Kolegjit se Komisioni, në dhënien e vendimit për çështjen e tij, ka shkelur parimin e sigurisë juridike, pasi ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga çështje të tjera të ngjashme, si dhe nga jurisprudenca e Kolegjit për sa i përket ligjshmërisë së kursimeve *cash*, si dhe mosdublimit të diferencës që vjen nga pasaktësitë në deklarinet në vite të kursimeve *cash*.
9. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit se ai nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë është i pambështetur në provat e administruara, si dhe në parashikimet ligjore që normojnë procesin e rivlerësimi kalimtar. Sipas subjektit të rivlerësimit, vetëm në rastet e deklarinet të më shumë se dyfishit të pasurisë, mund të merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, në situatat kur Komisioni nuk gjen prova për fshehje pasurie.

10. Në ankim, subjekti i rivlerësimit parashtron gjithashtu se, pas dhënies së vendimit, duke u vënë në dijeni të informacioneve të ardhura nga familjarët, ka konstatuar se relatorja e çështjes së tij në Komision, Valbona Sanxhaktari, ka qenë në konflikt interesi për shkak të marrëdhënieve të posaçme të babait të tij si anëtar i Gjykatës së Lartë, dhe babait të relatores, z. E. S., si prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.

- *Pretendime për vlerësimin e pasurisë*

11. **Për pasurinë “apartament banimi me sipërfaqe 126.4 m²”, në Durrës**, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, që ka njohur vetëm pjesërisht huan e dhënë nga shtetasja Zh. K. për pagesën e kësteve për blerjen e apartamentit. Subjekti pretendon se ka paraqitur në Komision dokumentacion që provon mundësinë financiare të huadhënësës për të dhënë huan me të ardhura të ligjshme. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit kërkon përfshirjen në analizën financiare të disa të ardhurave që nuk janë konsideruar nga Komisioni, si dhe kundërshton llogaritjen e shpenzimeve të jetesës nga Komisioni, duke pretenduar që shpenzimet për periudhën 1991 – 1997 të përllogariten në masën 30% të totalit të të ardhurave të gjithë familjes. Në konkluzion, subjekti pretendon se është i pabazuar përfundimi i arritur nga Komisioni për pamundësi të ardhurash të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.
12. **Për pasurinë “apartament me sipërfaqe 82.88 m²”, në Korçë, në pronësi të bashkëshortes së subjektit, shitur më datë 12.07.2007, subjekti i rivlerësimit pretendon se bashkëshortja e tij e ka blerë me të ardhura të ligjshme këtë pasuri në vitin 1997 dhe, si rrjedhojë, të ardhurat në shumën 6.000.000 lekë, të përfituara nga shitja e këtij apartamenti duhet të përfshihen në analizën financiare të Komisionit, për shkak se subjekti ka provuar ligjshmërinë e këtyre të ardhurave. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendon se përveç mosllogaritjes së disa të ardhurave, Komisioni ka llogaritur edhe shpenzimet e jetesës¹, në kundërshtim me praktikën e Kolegjit.**
13. **Për pasurinë “apartament me sipërfaqe 120 m²”, në rrugën “{***}”, Korçë, blerë në vitet 2008 – 2011**, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se, në analizën financiare duhet të përfshihen të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga punësimi tek “{***}” ShPK, sipas deklarimit të këtyre të ardhurave në deklaratat periodike vjetore. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendon se janë krijuar me burime financiare të ligjshme huaja e dhënë nga shtetasja L. T. për pagesën e kështit të tretë të apartamentit, si dhe huaja e dhënë nga shtetasi G. K. për pagesën e kështit të tretë dhe të katërt të apartamentit, dhe kërkon përfshirjen e këtyre huave në analizën financiare. Lidhur me pagesën e kështit të pestë në shumën 200.000 lekë, dhe të gjashtë në shumën prej 500.000 lekësh gjatë vitit 2010, subjekti i rivlerësimit pretendon përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave nga dhënia me qira e apartamentit në Durrës. Por, subjekti, në ankim arsyeton se, pavarësisht përfshirjes apo jo të këtyre të ardhurave, ai ka pasur mundësi të paguajë me të ardhura të ligjshme kështin e pestë dhe të gjashtë, në shumën 700.000 lekë, gjatë vitit 2010. Lidhur me dy kështet e tjera, në shumën 500.000 lekë, të paguara gjatë vitit 2011, me burim të ardhurat e subjektit nga mësimdhënia në universitet dhe të ardhurat e bashkëshortes, subjekti arsyeton se, pavarësisht se të ardhurat e deklaruara nga të ardhurat e subjektit si pedagog janë përfituar në korrik, dhe pagesa e kështit është bërë në prill, subjekti ka pasur mundësi të paguajë me të ardhura të ligjshme

¹ Për periudhën 1991 – 1993, shpenzimet jetike janë llogaritur në nivelin 100% të të ardhurave; shpenzimet e jetesës për periudhën 1994 – korrik 1995, llogaritur në nivelin 66% dhe shpenzimet jetike të nënës së bashkëshortes, në masën 100% të vlerës së pensionit.

këstet gjatë vitit 2011, në shumën 500.000 lekë, pasi analiza e tij financiare e vitit 2011 ka rezultuar me diferencë pozitive prej + 385.575 lekësh².

14. **Për kredinë në Raiffeisen Bank, në shumën 4.600.000 lekë**, subjekti i rivlerësimit parashtron se detyrimet ndaj bankës për shlyerjen e kredisë vazhdojnë ende. Prej vitit 2016, pagat e punonjësve të Gjykatës së Korçës kanë kaluar në Raiffeisen Bank dhe, që nga ky moment, pagesat e këstit mujor për shlyerjen e kredisë janë kryer në mënyrë automatike, menjëherë me kreditimin e pagës. Të gjitha detyrimet janë shlyer nga ankuesi. Ky fakt vërteton tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kredia është marrë nga ankuesi dhe është përdorur gjithmonë prej tij.
15. **Për pasurinë “automjet”, tip “Audi A4”, blerë në vitin 2014**, subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se është i gabuar konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri, pasi ajo është krijuar me të ardhura të ligjshme. Si burim për blerjen e automjetit, është përdorur shuma e ngelur nga kredia e marrë në Raiffeisen Bank, shlyerja e së cilës është deklaruar rregullisht në deklaratat periodike vjetore. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit shton se viti 2014, kur është blerë automjeti, rezulton me bilanc pozitiv.
16. **Për pasurinë “garazh”, në rrugën “{***}”, Korçë, blerë me aktmarrëveshje në datën 27.03.2015**, subjekti i rivlerësimit pretendon se kjo pasuri është krijuar me të ardhura të ligjshme. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat periodike vjetore mbi disponimin *cash* të vlerës së mbetur nga kredia, dhe destinacionin e përdorimit për shlyerje huaje e krijim pasurish, gjejnë pasqyrim dhe përputhen me aktet e administruara gjatë hetimit administrativ. Ndërsa, kalimi i fondeve në llogarinë e z. E. S., nuk tregon që kjo hua nuk i është kthyer përsëri.
17. **Lidhur me përdorimin e automjetit tip “Mercedes-Benz”**, subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se nuk e ka deklaruar përdorimin e tij në deklaratat periodike vjetore, pasi përdorimi i automjeteve nuk ka qenë i detyruar për t’u deklaruar, sipas ligjit nr. 9049. Subjekti e ka pasur në përdorim këtë automjet për shkak të marrëdhënieve të miqësisë me z. S. dhe, nëse do të donte ta blinte këtë automjet, për shkak të vlerës së vogël të tij, i kishte mundësitë financiare, pasi analiza financiare e vitit 2007 rezulton pozitive.
18. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji: - *Prishjen e vendimit nr. 641, datë 06.04.2023, dhe dërgimin e çështjes Komisionit për të vazhduar më tej me procedurën e rivlerësimit për kriteret e mbetura pa u vlerësuar; ose - gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike; konstatimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese, si dhe ato të parashikuara nga KEDNJ-ja, ndaj subjektit të rivlerësimit; çeljen e shqyrtimit gjyqësor dhe hetimin e dy kriterëve të reja; ndryshimin e vendimit nr. 641, datë 06.04.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Besnik Shehu, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.*

² Konstatohet se subjekti, në ankim, ka referuar diferencën pozitive të analizës së vitit 2011 të Komisionit. Ndërsa, referuar analizës financiare të viteve, të paraqitur në ankim, diferenca i ka rezultuar pozitive në vlerën + 575.131 lekë.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Aspekte procedurale

a) Mbi juridiksionin e Kolegjit

19. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Mbi legjitimitimin e ankuesit

20. Ankuesi Besnik Shehu, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka ushtuar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe, në zbatim të nenit F, pika 2 e Kushtetutës, legjitimohet *ratione personae* për të ankimuar vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
21. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Besnik Shehu është shpallur në seancë publike më datë 06.04.2023. Vendimi i arsyetuar nr. 641, datë 06.04.2023, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***}, datë 10.05.2023, të Komisionit, për të cilin subjekti i rivlerësimit ka marrë dijeni më datë 11.05.2023. Subjekti i rivlerësimit ka përcjellë në datën 25.05.2023 ankimin e tij kundër vendimit të Komisionit, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 25.05.2023. Bazuar në nenin 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor 15-ditor nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, dhe subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione temporis*.

c) Mbi formën e gjykimit të ankimit

22. Në përputhje me nenin 65 të ligjit 84/2016, shqyrtimi i ankimit, në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 49/2012), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.
23. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin drejtuar Kolegjit, ka paraqitur kërkesën për gjykimin e çështjes në seancë publike, me qëllim marrjen në shqyrtim dhe analizimin e provave të depozituara në dosjen e Komisionit, në funksion të konstatimit të gjendjes faktike dhe kryerjes së një analize të drejtë financiare, pasi hetimi administrativ i kryer në Komision është i pavlefshëm, për shkak të shkeljeve procedurale, si

dhe për çeljen e hetimit gjyqësor për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, dhe administrimin si prova të reja të disa akteve³ që i ka bashkëngjitur ankimit.

24. Trupi gjykues konstatoi se, subjekti i rivlerësimit, pavarësisht se pretendon për shkelje procedurale nga ana e Komisionit, nuk ka sjellë në ankim të dhëna konkrete për evidentimin e këtyre shkeljeve. Nga verifikimi i akteve dhe procedurave të ndjekura në Komision, nuk evidentohet ndonjë shkelje procedurale apo konstatim i gabuar i situatës faktike, në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor në Kolegj apo administrimin e provave të reja për korrigjimin e tyre, siç pretendon subjekti i rivlerësimit.
25. Për sa u përket akteve të sjella nga subjekti i rivlerësimit bashkë me ankimin, trupi gjykues, pasi verifikoi përmbajtjen e tyre, vlerësoi të refuzonte marrjen e tyre në cilësinë e provave si të panevojshme, si dhe, pasi fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen, bazuar në nenin 49, pika 6, shkronjat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 84/2016.
26. Për sa më sipër, në kushtet kur nuk identifikohet plotësimi i asnjë prej kërkesave të nenit 51, pika 1⁴ e ligjit nr. 49/2012, çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 641, datë 06.04.2023, u mor në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.

B. Mbi pretendimet e subjektit të rivlerësimit

B.1 Vlerësimi i pretendimeve mbi procesin e rregullt

27. Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankimin drejtuar Kolegjit, se Komisioni, në dhënien e vendimit për çështjen e tij, ka shkelur parimin e sigurisë juridike, pasi ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga çështje të tjera të ngjashme dhe nga jurisprudenca e Kolegjit, për sa i përket ligjshmërisë së kursimeve *cash*, si dhe mosdublimit të diferencës, që vjen nga pasaktësitë në deklaratimet në vite të kursimeve *cash*.
28. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit se ai nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë është i pambështetur në provat e administruara, si dhe në parashikimet ligjore që normojnë procesin e rivlerësimit kalimtar. Sipas subjektit të rivlerësimit, vetëm në rastet e deklaratimit të më shumë se dyfishit të pasurisë, mund të merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, në situatat kur Komisioni nuk gjen prova për fshehje pasurie.

³ Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkë më ankimin: (i) Vërtetim nr. {***} prot., datë 18.05.2023, të Prokurorisë së Përgjithshme; (ii) Vërtetim nr. {***} prot., datë 02.05.2025, i Gjykatës së Lartë; (iii) 3 vendime të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, të datave 14.09.1972 dhe 14.10.1972.

⁴ Neni 51, pika 1, përcakton që: “[...] 1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë”.

29. Lidhur me sa parashtron subjekti i rivlerësimit për qëndrime të ndryshme të Komisionit në çështje të ngjashme, trupi gjykues risjell në vëmendje qëndrimin e konsoliduar tashmë në jurisprudencën e tij⁵, se pretendimet për standarde të ndryshme të mbajtura nga Komisioni për çështje të ngjashme, së pari, nuk mund të adresohen *a priori* si shkaqe ankimi, për sa kohë që vendimmarrjet u përkasin trupave gjykues të ndryshëm, të cilët ushtrojnë veprimtarinë si të pavarur nga njëri-tjetri dhe, së dyti, se përcaktimi i dy standardizimeve lidhet domosdoshmërisht me analizat specifike të çdo rasti, të cilat meritojnë trajtim individual e, për pasojë, krijojnë vështirësi apo edhe pamundësi për konstatimin e këtij standardi, të pretenduar si të dyfishtë. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e gjendjes faktike, të provuara nga gjykimi dhe zbatimi i duhur i ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Përpos këtij arsyetimi, trupi gjykues sjell në vëmendje përgjegjësinë e tij si i vetmi organ gjyqësor i procesit të rivlerësimit, i cili garanton ruajtjen e trajtimit të barabartë të subjekteve, qoftë për shkak të ushtrimit të funksioneve gjyqësore, por edhe për shkak të kompozimit të tij.
30. Për pretendimin e subjektit të rivlerësimit se, në lidhje me kriterin e pasurisë, vetëm në rastin e deklaramit të më shumë se dyfishit të pasurisë, mund të merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, së pari, trupi gjykues vëren se vendimi për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit është marrë pasi është konstatuar se ai nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij dhe personave të lidhur, në kuptim të nenin D të Aneksit të Kushtetutë dhe, si rrjedhojë, është në kushtet e parashikuara në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, lexuar së bashku me nenin 33, pika 5, të po këtij ligji, për deklaramit të pamjaftueshëm të pasurisë. Nga ana tjetër, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e Kolegjit⁶ se, konstatimi i dyfishit të pasurisë së ligjshme është vetëm një ndër rrethanat ligjore të parashikuara nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016, që passjellin shkarkimin nga detyra, dhe se rastet për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, nuk janë kumulative, që do të thotë se, ndonëse nuk gjenden rrethana që mund të kualifikohen sipas nenit 61, pika 1 e ligjit, mund të gjenden dhe janë gjetur rrethana që kualifikohen sipas pikave të tjera të kësaj dispozite, të cilat, njësoj, urdhërojnë vendosjen e masës disiplinore.
31. Për sa u përket pretendimeve në raport me çështje konkrete të kriterit të vlerësimit të pasurisë (çështjet që kanë të bëjnë me kursimet *cash*, si dhe deklaramin e tyre në vite), si dhe me vlerësimin e provave nga Komisioni, trupi gjykues vlerësoi t'i analizojë ato në mënyrë integrale me shkaqet e tjera të ankimit, që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, me qëllim shmangien e përsëritjeve, si dhe për kryerjen e një analize gjithëpërfshirëse dhe të kuptueshme, në funksion të zgjidhjes së çështjes.
32. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se, pas dhënies së vendimit, duke u vënë në dijeni të informacioneve të ardhura nga familjarët, ka konstatuar se relatorja e çështjes së tij në Komision, znj. Valbona Sanxhaktari, ka qenë në konflikt interesi për shkak të marrëdhënieve të posaçme të babait të tij si ish-anëtar i Gjykatës së Lartë, dhe babait të relatores, z. E. S., si ish-prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme. Në mbështetje të këtij pretendimi, bashkëlidhur ankimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe aktet: (i) Shkresë nr. {***} prot., datë 18.05.2023, e Prokurorisë së Përgjithshme, sipas

⁵ Shih vendimet e Kolegjit nr. 7/2019 (JR), nr. 34/2021 (JR), nr. 48/2024 (JR) dhe nr. 51/2025 (JR).

⁶ Shih vendimet e Kolegjit nr. 32/2022 (JR), nr. 9/2023 (JR) dhe nr. 48/2024 (JR).

së cilës, z. E. S. ka ushtruar detyrën e prokurorit në disa rrethe për periudhën 1961 – 1968, si dhe detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme në periudhën 1970 – 1982. (ii) Vërtetim nr. {***} prot., datë 02.05.2023, i Gjykatës së Lartë, sipas së cilës, z. H. Sh. ka qenë anëtar i Gjykatës së Lartë për periudhën 01.10.1966 deri më 01.07.1976. (iii) Ekstrakte të disa vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Lartë, sipas të cilave, babai i subjektit të rivlerësimit ka qenë anëtar i trupit gjykues, dhe z. E. S. ka qenë prokuror i çështjes. Trupi gjykues, në vlerësim të sa parashtron subjekti i rivlerësimit, çmon se janë të pabazuara pretendimet e tij lidhur me konfliktin e prezumuar të interesit midis tij dhe relatores së çështjes, për shkak se baballarët e tyre, përkatësisht në pozicionin e gjyqtarit dhe të prokurorit, kanë qenë pjesë e gjykimin të disa procedimeve penale dekada më parë. Subjekti i rivlerësimit nuk sjell asnjë argument për të provuar konfliktin e interesit dhe, vetëm konstatimi i pozicionit të mëparshëm të babait të tij dhe lidhja e supozuar me relatore e çështjes, nuk mund të sjellë për rrjedhojë, edhe ekzistencën e një konflikti interesi të saj, parë kjo edhe nën dritën e përkufizimit të konfliktit të interesit dhe rasteve të vërtetimit të tij, sipas legjislacionit në fuqi.

33. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se rezultojnë të pambështetura në ligj pretendimet e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka cenuar parimet e procesit të rregullt ligjor.

B.2 Analiza e pretendimeve mbi vlerësimin e pasurisë

- *Për pasurinë “apartament banimi me sipërfaqe 126.4 m²”, në Durrës*

34. Në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Apartament banimi në qytetin e Durrësit, finalizuar me kontratë shitjeje me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.04.2015, midis shoqërisë ‘{***}’ dhe Besnik Shehu, E. Sh., në shumën 46.500 USD, në 1/2 pjesë [...]”*. Si burim për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: i) huan nga kunata Zh. K.; (ii) të ardhurat në shumën 11.500 USD, të përfituara në bazë të dëshmisë së trashëgimisë ligjore, me trashëgimlënës babanë, H. Sh.; (iii) huan prej 10.000 eurosh dhënë nga shtetasi P.K.
35. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Hyrje në qytetin e Durrësit, në ish-shtëpinë ku banojnë prindërit, hyrja 2+1, me kontratën e hartuar në datën 23.10.2004, midis meje dhe shoqërisë “{***}”, në vlerën 46.000 (dyzet e gjashtë mijë) euro, sipërfaqe sipas kontratës, 126 m². Paratë për pagesën e kësaj hyrjeje, i kam marrë borxh me kontrata të rregullta”*.
36. Komisioni, në vlerësim të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, ka pranuar si burime të ligjshme për këtë pasuri: (i) të ardhurat e përfituara nga trashëgimia e prindërve, në shumën ½ e vlerës së depozitës së tërhequr në datën 05.12.2003, në vlerën 1.200.000 lekë; (ii) të ardhurat pjesore nga huadhënia e shtetases Zh. K. për pagesën e kësteve, në shumën totale 13.130 USD, në vitet 2003 dhe 2004. Ndërsa, për huan e dhënë nga shtetasi P. K., Komisioni ka konkluduar se, duket se huadhënësi mund të ketë pasur mundësi të krijojë kursime në shumën 10.000 euro, dhënë hua subjektit të rivlerësimit për pagesën e dy kësteve të fundit të apartamentit, duke e marrë në konsideratë edhe këtë hua si burim për blerjen e apartamentit.
37. Në përfundim, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare për krijimin e pasurisë objekt vlerësimi në shumën (-) 1.374.626 lekë, dhe se ai nuk ka provuar me

dokumentacion ligjor burimet e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b”, të ligjit nr. 84/2016.

38. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin drejtuar Kolegjit, kundërshton konkluzionin e Komisionit për njohjen pjesërisht të huas së dhënë nga shtetasja Zh. K. për pagesën e kësteve për blerjen e apartamentit. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka paraqitur në Komision dokumentacionin që provon mundësinë financiare të huadhënësës për të dhënë huan me të ardhura të ligjshme. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit kundërshton llogaritjen e shpenzimeve të jetesës nga Komisioni, pasi shpenzimet e jetesës për vitin 2004 nuk u referohen të dhënave të Institutit të Statistikave (në vijim “INSTAT”), si dhe nuk dihet për sa persona janë përllogaritur. Sipas subjektit të rivlerësimit, shpenzimet e jetesës duhet të llogariten për personat e familjes, për të cilët janë dokumentuar të ardhurat, duke konsideruar se personat e tjerë të lidhur kanë krijuar edhe të ardhura informale, si dhe të ardhura të tjera gjatë viteve. Në konkluzion, subjekti i rivlerësimit pretendon se është i pabazuar përfundimi i arritur nga Komisioni për mungesë të të ardhurave të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.
39. Pasi shqyrtoi aktet e administruara në fashikull dhe analizoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues arriti në përfundimin se huadhënësja Zh. K. ka pasur mundësi për dhënien e huas për pagesën e kësteve për blerjen e apartamentit në vitet 2003 dhe 2004, por nuk u provua me dokumentacion justifikues ligjor mundësia e krijimit të të ardhurave për dhënien prej saj të huas për pagesën e dy kësteve në vitin 2005. Për rrjedhojë, në kushtet kur nuk arriti të provojë mbulimin plotësisht me të ardhura të ligjshme të një prej burimeve për krijimin e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b”, të ligjit nr. 84/2016. Konkluzioni i mësipërm i trupit gjykues për këtë pasuri mbështetet në arsyetimin e shtjelluar në vijim.
40. Lidhur me huan e marrë nga shtetasja Zh. K., nga deklaratimet në deklaratën *vetting*, si dhe në deklaratat periodike vjetore të pasurisë, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:
- (i) Në deklaratën *vetting*, për burimin e pasurisë “apartament”, në Durrës: “[...] Në këtë kohë, kunata ime Zh. K. kishte lënë në shtëpinë e prindërve të saj (ku unë banoja me ta) shumën e lekëve të përfituara nga puna e tyre, lekë të cilët dërgoheshin herë pas here nga djemtë e saj, pasi vetë ajo nuk mund të lëvizte për shkak të mungesës së dokumentacionit dhe, me lejen e saj për të vënë në qarkullim këto para, në datën 18.07.2003, kemi bërë pagesën e pjesës prej 10.550 USD, ku 10.000 janë të kunatës, dhe 550 USD i dispononim vetë si familje. [...] pagesë prej 3.130 USD, në datën 10.02.2005, kemi shlyer përsëri një kësht në shumën 2.820 USD; në datën 03.09.2005, kemi shlyer detyrimin prej 10.000 USD; në datën 14.01.2006, shumën 7.500 USD; në datën 22.03.2006, shumën prej 1.000 USD. Sipas kontratës së shitjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.04.2015, shuma është 46.500 USD. Burimi i këtyre shumave, siç kemi cituar më lart, është nga vlera e parave të dërguara nga kunata ime Zh. K. dhe, një pjesë tjetër, nga kontrata e huas që kemi lidhur me shtetasin P. K., me nr. {***} rep., {***} kol., datë 13.03.2006 (10.000 euro). [...] vlera totale e pagesës për këtë apartament ka qenë 35.000 USD, siç u citua më sipër, 11.500 USD nga dëshmia e trashëgimisë së babait, nga huaja e marrë Petraq Krekës dhe, një pjesë tjetër, nga shumat e marra hua kunatës sime Zh. K., kontratë huaje me nr. {***} rep., {***} kol., datë 13.03.2006, e përsëritur me nr. {***} rep., {***} kol., datë 12.02.2007, për shkak se ka humbur kontrata e parë. [...] Këto hua të marra nga kunata ime u përdorën edhe për shlyerjen e huas

P. K. Nga shuma e marrë hua prej 40.000 eurosh, një pjesë e kësaj shume është përdorur nga ana ime, si familje, si investim për rregullimin e çatisë së apartamentit ku banonim, e cila u përshtat si gjysmë ambient banimi dhe, sipas deklaratimit të bërë nga ana ime, aktualisht është në proces legalizimi, për të cilën bashkëngjis edhe dokumentet përkatëse. [...] për kunatën Zh. K., përveç punës së saj në të zezë, të ardhurat janë siguruar edhe nga fëmijët e saj të rritur, A. dhe G. K., për të cilët disponojmë siguracionet e paguara në lidhje me punën e bërë. [...]”

(ii) Në deklaratën periodike të vitit 2005, për apartamentin në Durrës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Sipas kontratës së huas, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.03.2006, i kam marrë hua kunatës Zh. K. 40.000 euro. Në dy këste (20+20), për një afat 10-vjeçar, duke filluar nga dhjetori i vitit 2004 deri në dhjetor 2014*”.

(iii) Në deklaratën periodike të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar huan e marrë, si dhe detyrimin e pashlyer, në shumën 40.000 (dyzet mijë) euro.

(iv) Në deklaratën e vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar likuidimin e detyrimeve financiare ndaj të tretëve, në shumën totale 6.000.000 lekë, me burim nga shitja e apartamentit në Korçë.

41. Bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale me përshkrimin “*Kontratë Huaje, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.2.2007*”, sipas së cilës, rezulton se huadhënësja Zh. K. i ka dhënë subjektit të rivlerësimit, në kohë të ndryshme e me këste, një shumë prej 40.000 eurosh, filluar me vlerën 28.000 USD në vitin 2003, si këste për shlyerjen e detyrimit kontraktor lidhur me blerjen e një apartamenti në qytetin e Durrësit. Sipas deklaratimit të subjektit në deklaratën *vetting*, dhënia e huas ka filluar në vitin 2003 me pagesën e pjesëshme të këstit të parë, në datën 18.07.2003, në shumën 10.000 (dhjetë mijë) USD. Në deklaratën e vitit 2003, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar marrëdhënien e huas me shtetasen Zh. K., dhe as disponimin si gjendje *cash* në fund të vitit, të diferencës së mbetur nga huadhënia në shumën 28.000 USD, pas pagesës së këstit të parë të apartamentit.
42. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *vetting*, gjatë hetimit administrativ në Komision, por edhe në ankim, në seksionin “analiza financiare e përgjithshme”, lidhur me huan e marrë nga znj. Zh. K., ka shpjeguar se është përdorur si burim: (i) për pagesën e kësteve të apartamentit në Durrës; (ii) për pagesën e shpenzimeve të djalit; (iii) për ndërtimin e papafingos në vitin 2004, dhe; (iv) si burim për shlyerjen e huas shtetasit P. K., në vitin 2006.
43. Nga verifikimi i akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe shtetasja Zh. K. kanë nënshkruar më parë një kontratë tjetër huaje, nr. {***}/{***}, datë 13.03.2006⁷, në të cilën konfirmohet huadhënia në vlerën 40.000 euro, me qëllim shlyerjen e kësteve për blerjen e apartamentit në Durrës, brenda vitit 2014.
44. Lidhur me të ardhurat e huadhënësës Zh. K. dhe familjarëve të saj, subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur me deklaratën *vetting*, ka paraqitur aktet: (i) Ekstrakt i llogarisë personale të sigurimeve shoqërore për shtetasin A. K., për periudhën 2002 – 2009. Vërtetim nënshkrimi nr. {***} rep., datë 24.01.2017, dhe përkthim vetëm për faqen e parë të ekstraktit, pjesa tjetër e dokumentacionit është në gjuhën greke. (ii) Ekstrakt i llogarisë personale të sigurimeve shoqërore për shtetasin G. K., periudha 2002 – 2008,

⁷ Akti i sjellë nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. {***} prot., datë 04.05.2022, dërguar Komisionit.

shoqëruar me vërtetim nënshkrimi nr. {***} rep., datë 24.01.2017, dhe përkthim vetëm për faqen e parë të ekstraktit, pjesa tjetër e dokumentacionit është në gjuhën greke.

45. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 09.07.2015, i pyetur mbi mundësitë financiare të shtetases Zh. K., subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kjo shtetase, së bashku me tre djemtë e saj emigrantë kanë punuar në Greqi, ku kanë bërë punë të ndryshme të padeklaruara, dhe ka dorëzuar si dokument provues, një ekstrakt të llogarisë personale të sigurimit shoqëror të djalit të huadhënësës, Sh. K., për 3-mujorin e fundit të vitit 2004, dhe një ekstrakt të llogarisë personale të sigurimit shoqëror të djalit tjetër, G. K., për vitin 2004.
46. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, për të provuar mundësinë financiare të shtetases Zh. K. për të dhënë huan, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Në të gjitha deklaratat vjetore, në dokumentet noteriale dhe në deklaratën vetting, është deklaruar e njëjta shumë e marrë hua, shuma 40.000 (dyzet mijë) euro. Kjo shumë është marrë nga z. Shehu nga kunata e tij, në kohë të ndryshme, nga paratë të cilat ajo apo familjarët e saj i sillnin herë pas here nga Greqia te prindërit e saj. Kontrata e huas apo deklarata noteriale nuk është përpiluar në momentin e marrjes së huas, për shkak të marrëdhënies së ngushtë motër-vëlla dhe, për këtë arsye, mund të ketë ndonjë pasaktësi për kohën ekzakte të marrjes së kësaj huaje, por është evidente se kjo hua është marrë me qëllim pagesën e disa kësteve të çmimit të apartamentit. Deklarimi për huan e marrë, në deklaratën vetting, përputhet me përmbajtjen e kontratës së huas së vitit 2006, por edhe atë të vitit 2007. Pra, z. Shehu ka deklaruar saktë marrëdhënien e huas në deklaratën vetting, deklaratë nga e cila fillon përgjegjësia e subjektit në procesin e rivlerësimit. Znj. K. ka sjellë paratë e kursyera në Greqi te prindërit e saj, të cilët jetonin së bashku me familjen e z. Shehu dhe, për këtë arsye, me lejen e saj, z. Shehu ka mundur t’i përdorë këto kursime për pagesat e kryera në shoqërinë e ndërtimit. Marrëdhënia e huas është formalizuar në vitin 2006, për shkak edhe të marrëdhënies së afërt të të dyja motrave. Subjekti ka bashkëlidhur dokumentacion shtesë lidhur me të ardhurat e djemve të shtetases Zh. K., ku rezulton se mundësia për kursime pas zbritjes së shpenzimeve jetike të jetë me balancë negative në shumën (-) 6.688 (gjashtë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë) euro. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar lidhur me burimet se: “Përveç të ardhurave në këto vite, z. Shehu ka mundur të sigurojë edhe dokumente që vërtetojnë të ardhurat e z. A. K. në vitet 1998 – 2001, në shumën 3.207.907 (tre milionë e dyqind e shtatë mijë e nëntëqind e shtatë) lekë. Gjithashtu, familja K., në vitin 1998, ka shitur edhe apartamentin e privatizuar në vitin 1993”.*
47. Bashkëlidhur prapësimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision kopje të noterizuara të pasaportave të anëtarëve të familjes K., nga të cilat vërtetohen hyrjet dhe daljet e këtyre shtetasve nga territori i Republikës së Shqipërisë, hyrje gjatë të cilave, sipas subjektit, janë sjellë dorazi shumat e dhëna hua. Në prapësime, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar edhe të ardhura të tjera shtesë të huadhënësës, duke shpjeguar se familja K., në vitin 1998, ka shitur apartamentin në qytetin e Beratit, në vlerën 600.000 lekë, duke paraqitur edhe kontratën e shitblerjes së këtij apartamenti.
48. Komisioni, pasi ka vlerësuar dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit lidhur me mundësitë financiare të huadhënësës, me burim nga të ardhurat nga puna e djemve emigrantë në Greqi, ka konkluduar se huadhënësja Zh. K., në mënyrë hipotetike, ka pasur mundësi për të dhënë hua në vitin 2003 në shumën 10.000 (dhjetë mijë) USD, mund të ketë pasur mundësi për të dhënë hua në vitin 2004

shumën 3.130 (tre mijë e njëqind e tridhjetë) USD, por ajo nuk ka pasur mundësi të japë hua në vitin 2005 për pagesën e dy kësteve, në shumën totale 12.820 (dymbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet) USD. Në konkluzion, Komisioni, në vlerësim të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ka pranuar si të ardhura me burime të ligjshme të ardhurat pjesore nga huadhënia e shtetasës Zh. K., në shumën totale 13.130 USD, për pagesën e kësteve në vitet 2003 dhe 2004. Në këtë konkluzion, Komisioni ka marrë në konsideratë edhe faktin që deklaratimet e kryera nga subjekti në deklaratën *vetting* lidhur me marrëdhënien e huas, vlerat e marra hua, koha kur është marrë huaja, nuk përputhen me kontratën e huas të dorëzuar në deklaratën *vetting*, dhe nuk gjejnë pasqyrim në deklaratimet periodike vjetore, në procesverbalet e ILDKPKI-së, në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, apo në parashtrimet e subjektit. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit janë konfuze dhe nuk krijojnë qartësi se kur ka filluar huaja dhe shuma e parë e marrë hua, dhe duket se kjo hua përdoret nga subjekti si burim për të mbuluar diferencat negative të analizës financiare ndër vite.

49. Në ankimin drejtuar Kolegjit, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit në lidhje me mundësinë financiare të personave të tjerë të lidhur, pasi, sipas tij, pavarësisht se paraqiti një sërë dokumentesh në formën e kërkuar nga ligji, Komisioni nuk i mori në analizë këto të dhëna, që burojnë nga provat e administruara, duke konkluduar, pa kryer një analizë financiare të të dhënave të reja, se huadhënësja ka pasur mundësi të huazojë vetëm 1/3 e shumës së huas. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni duhej që të dhënat shitesë që burojnë nga provat e dërguara nga subjekti, bashkëlidhur prapësimeve të tij mbi rezultatet e hetimit, t'i kishte analizuar dhe t'ia kishte nënshtruar një analize, duke marrë për bazë shpenzimet jetike për numrin e personave për të cilët rezultojnë se ka të ardhura. Familja K. ka realizuar të ardhura në emigracion në mënyrë formale dhe informale, por subjekti ka paraqitur vetëm të dhënat që anëtarët e familjes kanë mundur të sigurojnë në mënyrë të ligjshme.
50. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një analizë financiare të tijën, lidhur me personin tjetër të lidhur, Zh. K., për të cilën konkludon se familja e saj ka pasur mundësi me burime të ligjshme të krijonte kursime për periudhën 1998 – 2006, në total 40.815 euro, dhe të jepte huan prej 40.000 eurosh, duke arritur në përfundimin se huaja që ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit është e krijuar me të ardhura të ligjshme. Subjekti i rivlerësimit pretendon të përfshijë në analizën financiare mbi mundësinë e blerjes së apartamentit të gjithë shumën e marrë hua, në ndryshim nga Komisioni, i cili ka përfshirë vetëm vlerën e provuar nga aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision.
51. Për sa ka parashtruar subjekti i rivlerësimit në ankim, trupi gjykues, së pari, konstaton se nuk qëndrojnë pretendimet e tij se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë dhe nuk ka analizuar dokumentacionin e paraqitur prej tij gjatë hetimit administrativ, për të justifikuar dhënien e huas. Nga verifikimi i kryer në aktet e fashikullit të Komisionit, rezulton se analiza financiare për mundësinë për kursime për personin tjetër të lidhur, huadhënësen Zh. K., në vendim, është e ndryshme nga analiza financiare e kryer në rezultatet e hetimit. Në analizën financiare në raportin e rezultateve të hetimit, për pasurinë “apartament” në Durrës, nga Komisioni nuk është konsideruar asnjë kësht i pagesës së apartamentit si i mbuluar nga huaja e dhënë nga shtetasja Zh. K., ndërsa në vendim, Komisioni, siç edhe është shprehur (paragrafi 1.56 nënçështja “v”, paragrafët 1.57 dhe 1.58), *pasi ka vlerësuar dokumentacionin shitesë të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit lidhur me mundësinë financiare të huadhënëses, me burim nga të ardhurat nga*

puna e djemve emigrantë në Greqi, ka konsideruar si hua me burime të ligjshme për pagesën e kësteve të apartamentit vlerën në total prej 13.130 USD, nga e cila 10.000 USD në vitin 2003 dhe 3.130 USD në vitin 2004.

52. Nga aktet në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, për të vërtetuar mundësitë financiare të huadhënëses, ka paraqitur dokumentacion vetëm për të ardhurat e realizuara nga djemtë e huadhënëses për periudhën 1998 – 2009 (ekstrakte të llogarive personale të sigurimeve shoqërore), të cilat janë sjellë në greqisht dhe të përkthyer në shqip. Në këto ekstrakte, përshkruhen ditët e punës, paga dhe kontributi i llogaritur, por nuk përcaktohet nëse paga është bruto apo neto, ashtu siç ka evidentuar edhe Komisioni në vendim, në paragrafin 1.23, shkronja “c” të tij.
53. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar që të merren në konsideratë edhe të ardhura shtesë të huadhënëses, duke shpjeguar se familja K., në vitin 1998, ka shitur apartamentin në qytetin e Beratit, në vlerën 600.000 lekë, dhe se ka paraqitur në Komision kontratën e shitblerjes së këtij apartamenti. Ashtu siç edhe ka konstatuar Komisioni, trupi gjykues vëren se ky burim nuk është deklaruar në deklaratën *vetting*, dhe se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë burim tjetër të ardhurash të huadhënëses, vetëm pasi është njohur me rezultatet e hetimit dhe, dukshëm, është një përpjekje e subjektit të rivlerësimit për të shtuar mundësitë financiare të huadhënëses. Për këto arsye, trupi gjykues vlerëson se është i drejtë qëndrimi i Komisionit se këto të ardhura nuk mund të llogariten në mundësitë financiare të huadhënëses, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se ato mund të jenë shpenzuar për arsye të ndryshme, duke qenë se, gjatë kësaj periudhe, rezulton se anëtarët e kësaj familjeje kanë emigruar në Greqi.
54. Lidhur me mundësinë financiare të huadhënëses për dhënien e huas, për të ardhurat e realizuara nga familja e saj, dhe mundësisë për kursime për periudhën 2002 – 2006 (periudhë gjatë së cilës janë bërë pagesat e kësteve të apartamentit), mbështetur në aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, lidhur mbi të ardhurat (ekstrakte të llogarive personale të sigurimeve shoqërore) ndër vite të djemve të huadhënëses, pas verifikimit të kryer në Kolegj, rezulton se personi tjetër i lidhur, huadhënësja, deri në vitin 2001, ka pasur mundësi për kursime në vlerën 5.671 euro⁸, në vitin 2002, në vlerën prej 637 eurosh⁹ dhe, në total, në vlerën 6.308 euro kursime, me të cilat, pothuajse mbulohet huaja për këstin e parë të apartamentit në Durrës prej 8.132 eurosh (ekuivalent me vlerën 10.000 USD), paguar në datën 18.07.2003, por nuk mbeten kursime për pagesat e kryera në vitet e tjera. Pra, huadhënësja Zh. K. ka pasur mundësi për të dhënë hua vetëm për pagesën e kështit të parë të apartamentit në Durrës, në vlerën

⁸ Në Kolegj, sipas verifikimit të akteve në fashikujt e Komisionit dhe pretendimit të subjektit të rivlerësimit për analizën e mundësisë së kursimit për periudhën 1998 – 2001, u evidentuan: a) të ardhurat e periudhës 1998 – 2001 janë në vlerën 21.398 euro, 416 euro më pak nga analiza e subjektit në ankim (diferencat janë si kombinim i: në vitin 1999, nga aktet, rezultojnë më shumë të ardhura nga analiza e subjektit, prej 195.000 dhrahmi, ekuivalent me 668 euro dhe, në vitin 2001, më pak të ardhura nga analiza e subjektit prej 347.625 dhrahmi, ose ekuivalenti prej 1.084 eurosh); b) shpenzimet jetike, pavarësisht se në tabelë referohen si “shpenzime jetike Eurostat”, nga verifikimi i të dhënave në Eurostat (https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ilc_li01__custom_17092955/default/table?lang=en) për periudhën 1998 – 2001, janë në vlerën 16.075 euro (sipas Eurostat, për një person në Greqi, shpenzimet e jetesës në nivelin e varfërisë “at-risk-of-poverty threshold” janë 3.847 euro në 1998, 3.810 euro në 1999, 4.154 euro në vitin 2000 dhe 4.264 euro në 2001), 626 euro më shumë nga analiza e subjektit në ankim, dhe kursimet e mundshme deri në vitin 2001 janë 5.671 euro (730 euro më pak se sa pretendon subjekti në analizën financiare në ankim).

⁹ Të ardhurat totale në vitin 2002 janë në vlerën prej 13.429 eurosh (nga A. K. 5.931 euro + nga G. K. 4.007 euro, dhe nga Sh. K. 3.491 euro) dhe, duke zbritur shpenzimet për 3 persona nga Eurostat prej 12.792 eurosh, rezulton një kursim në vlerën 637 euro.

10.000 USD, ose ekuivalenti me 8.132 euro, por nuk u provua me dokumentacion justifikues ligjor mundësia e krijimit të të ardhurave për dhënien prej saj të huas për pagesën e dy kësteve në vitin 2005. Në ndryshim nga Komisioni, nga analiza e kryer në Kolegj, rezulton se huadhënësja nuk ka pasur mundësi të jepte hua as për pagesën e kështit prej 3.130 USD në vitin 2004.

55. Në referim të shkakut të ankimit të subjektit të rivlerësimit, lidhur me llogaritjen e shpenzimeve të jetesës të personave të tjerë të lidhur (huadhënëses dhe familjarëve të saj), trupi gjykues vëren se shpenzimet e pretenduara nga subjekti për analizën e viteve 2002 – 2006 janë më të ulëta, sipas analizës së kryer prej tij në ankim. Subjekti i rivlerësimit pretendon se shpenzimet e jetesës duhet të konsideroheshin vetëm për personat për të cilët janë dokumentuar të ardhurat, ndërkohë që konstatohet se, pikërisht ky është edhe vlerësimi që ka bërë Komisioni, i cili, për vitin 2002, ka konsideruar të ardhurat për dy persona, po ashtu edhe shpenzimet janë konsideruar për dy persona¹⁰ ndërsa, për vitet 2003, 2004, 2005 e 2006, Komisioni ka konsideruar të ardhura për tre persona e, po ashtu, edhe shpenzimet i ka konsideruar për tre persona¹¹. Trupi gjykues konstaton se nuk është e qartë se cilit burim zyrtar i është referuar subjekti i rivlerësimit për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës, pasi, në ankim, ai u referohet shpenzimeve jetike sipas Eurostat-it, por të dhënat janë të ndryshme nga ato të Komisionit, i cili, gjithashtu, në analizën financiare, u referohet shpenzimeve sipas Eurostat-it. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se nuk qëndron shkak i ankimit të subjektit të rivlerësimit për reduktim të shpenzimeve të jetesës, të cilat mbeten të njëjta me ato të llogaritura nga Komisioni, me burim nga Eurostat-i për Greqinë, sipas viteve, dhe për numër personash, për të cilët ka të dhëna të të ardhurave.
56. Në përfundim, për pasurinë “apartament” në Durrës, referuar ankimit të subjektit të rivlerësimit për mundësinë e krijimit të tij me burimin e deklaruar nga huaja e znj. Zh. K., sipas analizës së thjeshtë të kryer në Kolegj, rezulton se personi tjetër i lidhur, potencialisht mund të jepte hua shumë prej 10.000 USD (ekuivalente me 8.132 euro ose 1.086.900 lekë), dhe subjekti do të rezultonte me pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në vlerën (-) 1.670.661 lekë¹². Për shkak të mospërkeqësimit të situatës së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson të konfirmojë përfundimin e Komisionit se, personi tjetër i lidhur, huadhënësja Zh. K., ka pasur mundësi të jepte hua vetëm vlerën 13.130 USD nga vlera e pretenduar prej 40.000 eurosh. Për rrjedhojë, në kushtet kur nuk arriti të provojë mbulimin plotësisht me të ardhura të ligjshme të një prej burimeve për krijimin e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit në vlerën prej (-) 1.374.626 lekësh, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
- Për pasurinë “apartament me sipërfaqe 82.88 m²”, në Korçë, në pronësi të bashkëshortes së subjektit, shitur më datë 12.07.2007

¹⁰ Në mungesë të të dhënave për vitin 2002, janë konsideruar të dhënat për vitin 2001.

¹¹ Sipas informacionit nga:

https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ilc_li01_custom_17092955/default/table?lang=en, shpenzimet në nivelin e varfërisë “at-risk-of-poverty threshold”, për vitin 2004, për një person, ishin 5.306 euro dhe, për 3 persona, 15.918 euro (5.306 euro x 3 persona).

¹² Diferenca prej 296.035 lekësh nga rezultati i Komisionit konsiston në moskonsiderimin e vlerës 3.130 USD, si hua nga Zh. K., për mbulimin e kështit të tretë të pagesës në datën 23.10.2004.

57. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting* të ardhura në vlerën 6.000.000 lekë nga shitja, në vitin 2007, e pasurisë “apartament banimi”, në pronësi të bashkëshortes E. Sh., dhe përdorimin e këtyre të ardhurave si burim për kthimin e huas kumatës Zh. K., si dhe pagesën e kështit të parë për pasurinë e kontraktuar, me palë shoqërinë “{***}” ShPK. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting* se apartamenti ndodhet në proces legalizimi për ndërtimin e një papafingoje. Si burim për blerjen e këtij apartamenti nga bashkëshortja, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat nga shitja në vitin 1997 të një apartamenti në Elbasan, në pronësi të bashkëshortes dhe të nënës së saj.
58. Bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.07.2007, të apartamentit në Korçë, vërtetimin nr. {***} prot., datë 17.10.2016, të Drejtorisë së ALUIZNI-t Korçë, si dhe vetëdeklarimin për legalizim, të datës 10.11.2006.
59. Drejtoria Vendore e ASHK-së Korçë, me shkresën nr. {***}, datë 12.10.2022, ka informuar Komisionin se pasuria “apartament banimi me sipërfaqe 82.88 m²”, në qytetin e Korçës, ka figuruar në pronësi të shtetasës E. Sh., duke përcjellë dokumentacionin e disponuar, nga i cili rezulton se: (i) shtetasja E. Sh., në cilësinë e palës blerëse, ka nënshkruar kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.10.1997, me palë shitëse shtetasin V. P., për blerjen e pasurisë “apartament banimi” kundrejt vlerës 1.800.000 lekë, paguar jashtë zyrës noteriale; (ii) shtetasja E. Sh., në cilësinë e palës shitëse, ka nënshkruar kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.07.2007, me palë blerëse shtetasin E. Q. S.¹³, për apartamentin me sipërfaqe 82.88 m², kundrejt vlerës 6.000.000 lekë, dhe se çmimi i kësaj pasurie është likuiduar *cash* jashtë zyrës noteriale. Nga dokumentacioni, rezulton se është paguar edhe tatimi përkatës për kalimin e pronësisë së apartamentit.
60. Komisioni, në rezultatet e hetimit, ka konstatuar se çmimi i shitjes së apartamentit duket i lartë dhe jo në raport me vlerën reale të sendit, apo dokumentet e vlerësimit, sipas bankës. Blerësi E. Q. S. ka aplikuar për kredi për blerjen e pasurisë “apartament banimi me sipërfaqe 82.88 m²”, në qytetin e Korçës, por fondet e kredisë nuk rezulton të jenë përdorur për blerjen e apartamentit, por janë kaluar në përdorim të shoqërisë tregtare “{***}” ShPK, në pronësi të nënës së këtij shtetasi. Faturat e shërbimeve utilitare për apartamentin kanë vijuar të jenë në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të paguhen prej tij, edhe pas shitjes së apartamentit. Komisioni ka ngritur dyshime se kjo pasuri mund të jetë në posedim të subjektit të rivlerësimit, dhe se kontrata e shitblerjes mund të jetë fiktive, për këtë arsye, të ardhurat nga shitja e këtij apartamenti nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare të Komisionit. Për këto konstatime, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, për të provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se nuk ndodhet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, duke provuar mundësitë financiare për krijimin e kësaj pasurie, si dhe shitjen e saj.
61. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se: *Referuar Udhëzimit nr. 2, datë 04.04.2007, të Entit Kombëtar të Banesave, sipas një përllogaritjeje, vlera totale e shitjes së kësaj pasurie me sipërfaqe totale 163 m² është 7.693.763 lekë. Në këto kushte, çmimi i shitjes së kësaj pasurie, në shumën 6.000.000 lekë, është më i ulët se çmimi i lirë i tregut sipas EKB-së. Z. E. S. ka përfutuar kredi hipotekore për blerjen e pasurisë “apartament” dhe fondet e kredisë kanë kaluar në përdorim të shoqërisë tregtare “{***}” ShPK (shoqëri e nënës së tij), sepse vlera e apartamentit është*

¹³ Djali i motrës së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

paguar në datën 12.07.2007. Pra, logjikisht, z. S. ka paguar çmimin e shitjes së apartamentit, duke përdorur fonde nga xhiroja e shoqërisë dhe, pasi është disbursuar kredia, fondet kanë kaluar në shoqëri, për të likuiduar huan e marrë për pak ditë në shoqëri, për pagesën e çmimit të apartamentit. [...] Faturat e shërbimeve utilitare kanë vijuar të jenë në emër të z. Shehu, për shkak të neglizhencës dhe për shkak të miqësisë dhe marrëdhënies shumë të mirë familjare me z. S. Kjo pasuri, nga muaji korrik i vitit 2008, është në posedim të motrës së z. S., dhe kontrata e shitblerjes është më se reale.

62. Lidhur me burimet e ligjshme për krijimin e pasurisë “apartament me sipërfaqe 82.88 m²”, në vitin 1997, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në Komision se: “Pasuria ‘apartament banimi me sipërfaqe 82,88 m²’, në qytetin e Korçës është blerë me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.10.1997, me palë shitëse shtetasin V. P., për blerjen e pasurisë ‘apartament banimi’ kundrejt vlerës 1.800.000 (një milion e tetëqind mijë) lekë, paguar jashtë zyrës noteriale. Ndërsa, pasuria ‘apartament banimi’ në qytetin e Elbasanit është shitur me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***}, datë 27.08.1999, me palë shitëse E. Sh., dhe palë blerëse B. H., në vlerën 400.000 (katërqind mijë) lekë. Në atë kohë, babai i bashkëshortes i premtoi shitjen e banesës në qytetin e Elbasanit shtetases B. H. në shumën 850.000 (tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe babai i bashkëshortes ka marrë në dorë nga kjo shtetase një shumë prej 450.000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekësh të rinj. Rezulton se në datën 27.08.1999, blerësja e apartamentit ka dorëzuar edhe shumën e mbetur prej 400.000 (katërqind mijë) lekësh të rinj, dhe është hartuar kontrata e shitblerjes për kalimin e pronësisë. Theksoj se, kontrata përmban shënimin, si shumë blerjeje, atë shumë që blerësja ka dorëzuar atë ditë, prej 400.000 (katërqind mijë) lekësh (shkakun pse, nuk mund ta shpjegoj), por që banesa është shitur në shumën 850.000 (tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë të rinj, është më se e vërtetë”.
63. Subjekti i rivlerësimit, duke iu referuar analizës financiare të Komisionit për mundësinë e blerjes së apartamentit në Korçë në vitin 1997, ka pretenduar të ardhura shtesë për veten dhe bashkëshorten e tij, konkretisht të ardhura në shumën 1.394.145 lekë, të përfituara gjatë periudhës qershor 1991 – 1995 në funksionin e ushtarakut, të ardhurat e bashkëshortes nga punësimi për periudhën maj 1994 – prill 2001, të ardhurat në shumën 450.000 lekë, të marra nga babai i bashkëshortes në vitin 1996 nga shitja e apartamentit me kontratë shitblerjeje në vitin 1999, si dhe ardhurat e pensionit të babait të bashkëshortes, për shkak të jetesës së përbashkët.
64. Në përfundim, Komisioni, duke marrë në konsideratë disa nga pretendimet e subjektit të rivlerësimit për të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes, si dhe për shpenzimet e jetesës, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare për blerjen e apartamentit 82.88 m², në Korçë, në shumën (-) 1.107.701 lekë, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
65. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin drejtuar Kolegjit, kundërshton konkluzionin e Komisionit dhe pretendon se bashkëshortja e tij e ka blerë me të ardhura të ligjshme këtë pasuri në vitin 1997 dhe, si rrjedhojë, të ardhurat në shumën 6.000.000 lekë, të përfituara nga shitja e këtij apartamenti, duhet të përfshihen në analizën financiare të Komisionit, për shkak se subjekti ka provuar ligjshmërinë e këtyre të ardhurave. Subjekti i rivlerësimit kërkon përfshirjen në analizën financiare të shumës 450.000 lekë, të përfituar nga babai i bashkëshortes për shitjen e apartamentit në Elbasan, në ndryshim nga Komisioni, që nuk ka e konsideruar këtë shumë, si dhe të të ardhurave nga pensioni i babait të bashkëshortes.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimi pretendon se, përveç mosllogaritjes së disa të ardhurave, Komisioni ka llogaritur edhe shpenzimet e jetesës¹⁴ në kundërshtim me praktikën e Kolegjit. Subjekti i rivlerësimi pretendon se, duke qenë se ka përfiturar të ardhura si ushtarak, të ardhurat e përgjithshme të familjes janë të larta dhe, si rrjedhojë, shpenzimet jetike të periudhës 1991 – 1997 duhet të përllogariten në masën 30% të totalit të të ardhurave të të gjithë familjes.

66. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimi për përfshirjen në analizë të të ardhurave me vlerë prej 450.000 lekësh nga shitja e apartamentit në Elbasan në vitin 1996, nga verifikimi i akteve në fashikullin e Komisionit rezulton se:

66.1. Sipas kontratës së shitblerjes nr.

66.2. {***} rep., nr. {***}, datë 27.08.1999, është kryer shitja e apartamentit në lagjen “{***}”, në Elbasan, me palë shitëse shtetasen E. Sh., dhe palë blerëse shtetasen B. H., në vlerën 400.000 lekë.

66.3. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimi ka sqaruar se prindërit e bashkëshortes ia kanë dhuruar pasurinë “shtëpi banimi”, në Elbasan, vajzës së tyre E. Sh., për shkak të jetesës së përbashkët. Subjekti ka bashkëlidhur si dokumentacion provues: (i) testamentin datë 16.11.1994, ku testatorët A. T. dhe R. T. caktojnë si përfituese të pasurisë apartament banimi në qytetin e Elbasanit vajzën e tyre, E. Sh., me të cilën bashkëjetojnë dhe, kësaj shtetaseje, i lind e drejta e kalimit të pronësisë pas vdekjes së prindërve; (ii) Kontratën e dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.04.1997, ku shtetasit A. T. dhe R. T. deklarojnë se banesën në pronësinë e tyre ia dhurojnë vajzës së tyre, E. Sh., me të cilën kanë vite që bashkëjetojnë.

66.4. Po në pyetësorin nr. 2, subjekti i rivlerësimi ka sqaruar se: *babai i bashkëshortes i premtoi shitjen e banesës në qytetin e Elbasanit shtetasen B. H., në shumën 850.000 lekë, dhe babai i bashkëshortes ka marrë në dorë nga shtetasja B. H. një shumë prej 450.000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekësh të rinj. Rezulton se, në datën 27.08.1999, blerësja e apartamentit ka dorëzuar edhe shumën e mbetur prej 400.000 lekësh, dhe është hartuar kontrata e shitblerjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.08.1999, për kalimin e pronësisë. Theksoj se, kontrata përmban shënimin, si shumë blerjeje, atë shumë që blerësja ka dorëzuar atë ditë prej 400.000 lekësh (shkakun pse, nuk mund ta shpjegoj), por, që banesa është shitur në shumën 850.000 lekësh të rinj, është më se e vërtetë.*

66.5. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, për të vërtetuar përfitimin e shumës 450.000 lekë, më datë 01.10.1996, nga babai i bashkëshortes, subjekti i rivlerësimi ka paraqitur një deklaratë noteriale me nr. {***}/***, datë 14.2.2023, në bazë të së cilës, znj. B. H. shpjegon faktet për blerjen e apartamentit dhe pranon se i ka paguar babait të znj. Sh., në datën 01.10.1996, shumën 450.000 lekë për blerjen e apartamentit dhe pjesën tjetër të çmimit e ka paguar në vitin 1999, kur është bërë kontrata e shitjes. Bashkëlidhur kësaj deklarate, subjekti i rivlerësimi ka paraqitur edhe një letër/vërtetim me

¹⁴ Për periudhën 1991 – 1993, shpenzimet jetike janë llogaritur në nivelin 100% të të ardhurave; shpenzimet e jetesës për periudhën 1994 – korrik 1995 janë llogaritur në nivelin 66% dhe shpenzimet jetike të nënës së bashkëshortes, në masën 100% të vlerës së pensionit.

shkrim dore nga znj. B. H., që, sipas tij, vërteton tej çdo dyshimi shpjegimin e dhënë prej tij dhe nga kjo shtetase, për dhënien e shumës 450.000 lekë.

67. Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga shitja e apartamentit në Elbasan, në pronësi të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, pasi si arsyeton në vendim (paragrafi 2.31, “c”): *“Të ardhurat e pretenduara në shumën 450.000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë, të marra nga z. T. në vitin 1996 nga shitja e apartamentit me kontratë shitblerjeje në vitin 1999, ...nuk provohen në ndonjë formë apo dokumentacion ligjor, pasi çmimi i shitjes së kësaj pasurie ka qenë në shumën 400.000 lekë, dhe apartamenti në Elbasan është shitur në vitin 1999, pra 2 vjet pasi është blerë apartamenti në Korçë”*.
68. Për sa paraqitur më sipër, trupi gjykues vëren se kontrata për shitblerjen e apartamentit në Elbasan është e datës 27.08.1999, dhe të ardhurat prej 400.000 lekësh të përfituara prej saj, nuk mund të jenë përdorur si burim për blerjen e apartamentit në Korçë dy vite më parë, në datën 03.10.1997. Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me akte, as përfitimin nga babai i bashkëshortes të shumës 450.000 lekë në datën 01.10.1996, shumë që ai pretendon se ka qenë pjesë e çmimit të shitjes së apartamentit dhe që ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në Korçë në vitin 1997. Letra me shkrim dore e shtetases B. H., e sjellë nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit, nuk ka vlerë provuese, si për shkak të formës së saj, ashtu edhe të momentit kur është paraqitur në Komision, pas njohjes me analizën financiare në rezultatet e hetimit. Edhe deklarata noteriale nr. {***/**}, datë 14.02.2023, e shtetases B. H., nuk vërteton pretendimet e subjektit të rivlerësimit, pasi është një akt që është prodhuar për efekt të procesit të rivlerësimit. Me këto akte, nuk provohet pagesa prej 450.000 lekësh në vitin 1996 apo vlera e pretenduar e shitjes së apartamentit prej 850.000 lekësh, në kushtet kur akti ligjor, kontrata e shitblerjes së apartamentit e datës 27.08.1999, referon si çmim shitblerjeje vlerën 400.000 lekë. Në konkluzion, referuar këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se, është i bazuar konkluzioni i Komisionit, i cili nuk ka marrë në konsideratë dhe përfshirë në analizën financiare të periudhës 1991 – tetor 1997, vlerën e përfituar nga shitja e apartamentit në Elbasan.
69. Lidhur me të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se, në ndryshim nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka përfshirë në analizën financiare të viteve 1991 – 1995 të ardhurat nga paga e bashkëshortes, në vlerën 192.015 lekë. Referuar akteve në fashikuj, sjellë nga subjekti i rivlerësimit në Komision me prapësimet e datës 05.03.2023, konkretisht vërtetimit për vjetërsinë në punë të bashkëshortes për efekt pensioni, nr. {***} prot., datë 03.03.2020, vërtetimeve për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, si dhe shkresës së datës 01.06.2020 të Institutit të Sigurimeve Shoqërore (në vijim “ISSh”), Drejtoria Rajonale Elbasan, referuar të dhënave për bazën e vlerësuar, të indeksuar në vite, për znj. E. Sh., mbi të cilën janë bërë përlllogaritjet për pensionin, konstatohet se, realisht, rezultojnë të ardhura për periudhën 1991 – 1994, të cilat nuk janë përfshirë nga Komisioni në analizën financiare të periudhës 1991 – tetor 1997. Bazuar në të dhënat nga aktet e sipërcituara, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat prej 133.492 lekësh, që i përkasin periudhës 1991 – 30 prill 1994¹⁵, duhet të përfshihen në analizën financiare, së bashku me të ardhurat e tjera të

¹⁵ Në këto vite, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka punuar, sipas akteve, në Uzinën Mekanike Elbasan, si metalurge deri në shkurt 1993; nga shkurt 1993 – janar 1994, me trajtim asistencë papunësie nga Uzina Mekanike Elbasan; janar 1994 – prill 1994, Reparti “6959”, Uzina e Mjekësit, Elbasan.

konsideruara edhe nga Komisioni, që arrijnë në total për periudhën në analizë, në vlerën prej 290.433 lekësh¹⁶.

70. Lidhur me të ardhurat e pensionit të babait të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka argumentuar mospërfshirjen e tyre në analizën financiare, pasi ato janë pretenduar vetëm pas njohjes me rezultatet e hetimit dhe nuk janë provuar me dokumentacion provues, por edhe nëse do të konsideroheshin si të ardhura pensioni, ato duhet të jenë shpenzuar për të mbuluar shpenzimet jetike. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, pretendon se bashkëshortja e tij ka qenë në pamundësi të sigurojë dokumentacion për të ardhurat nga pensioni i babait të saj, për shkak se nga ISSh-ja është vërtetuar se disa dosje janë dëmtuar, por, edhe për shkak se z. A. T. ka ndërruar jetë. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni duhet t'i kishte përlllogaritur këto të ardhura në vlerë të barabartë me pensionin e nënës së bashkëshortes.
71. Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues konstaton se, bashkëlidhur prapësimeve ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sjellë një kopje të noterizuar, vërtetim njësie me origjinalin, nr. {***}, datë 23.02.2023, të librezës së pensionit të babait të bashkëshortes, z. A.T., si dhe shkresën nr. {***}, datë 02.03.2023, të ISSh-së, Drejtoria Rajonale Elbasan, sipas së cilës, për pensionin që ka përfutuar z. A. T. deri në vitin 1999, nuk gjenden dosjet, pasi janë dëmtuar, referuar edhe procesverbalit me shkrim dore të institucionit. Sipas akteve të përmendura më sipër, në të cilat jepen indicie se babai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, z. A. T., ka përfutuar pension pleqërie, akteve të tjera në fashikuj,¹⁷ si dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit se ai dhe familja e tij kanë jetuar me prindërit e bashkëshortes, në kushtet kur, në momentin e blerjes së apartamentit për të cilin po kryhet analiza e mundësisë së blerjes, ata kanë qenë në të njëjtën njësi familjare, derisa u transferuan në Korçë, së bashku në tetor 1996, trupi gjykues çmon se, duket se qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit që, në analizën financiare duhet të përfshihen edhe të ardhurat nga pensioni të babait të bashkëshortes. Në kushtet që nuk ka një informacion zyrtar për të ardhurat nga pensioni i babait të bashkëshortit, por ka indicie se ai ka përfutuar pension pleqërie, trupi gjykues vlerëson se në analizën financiare duhet të konsiderohen minimalisht të ardhurat e pensionit të babait të bashkëshortes, të llogaritura njësoj sa të ardhurat nga pensioni të nënës së bashkëshortes së subjektit. Referuar akteve në fashikuj, shkresës së ISSh-së nr. {***} prot., datë 09.09.2020, sjellë nga subjekti bashkëlidhur prapësimeve ndaj rezultateve të hetimit, në të cilën jepen në mënyrë të detajuar ndryshimet e pensioneve në muaj e gjatë viteve, për nënën e bashkëshortes së subjektit, të ardhurat nga pensioni kanë qenë në total, në vlerën prej 172.171 lekësh¹⁸.

¹⁶ Përkatësisht, 47.862 lekë më pak se në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe 162.144 lekë më shumë se në analizën e Komisionit.

¹⁷ Vërtetim Bashkia Korçë, Rajoni nr. 3, me nr. {***} regj., datë 08.09.2020, bashkëlidhur prapësimeve, ku vërtetohet se subjekti ka filluar të jetë banues në Korçë që në janar 1994 e, në vijim, ka tërhequr familjen dhe prindërit e bashkëshortes në tetor 1996.

¹⁸ Përkatësisht, 20.700 lekë më pak se në analizën e subjektit të rivlerësimit dhe 18.712 lekë më pak se në analizën e Komisionit. Konstatohet se, në analizën e tij, subjekti ka llogaritur dy herë pensionet e vitit 1995, një herë i ka konsideruar deri në qershor, pastaj e ka konsideruar të plotë vitin 1995 te totali i të ardhurave për periudhën 1995 – 1997. Ndërsa, Komisioni i ka konsideruar të ardhurat si përpjesëtimore të pensionit, të vërtetuar të përfutuar në total të viteve, sipas shkresës vërtetim nr. {***} prot., datë 24.01.2017, të ISSh-së (dosja e ILDKPKI-së).

72. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës për periudhën 1991 – 1997, konstatohet se Komisioni, si referon në vendim, ka llogaritur shpenzimet e jetesës në analizë: *“për periudhën qershor 1991 – 1995, përkatësisht për periudhën 1991 – 1993, llogaritur në nivelin 100% të të ardhurave; shpenzimet e jetesës për periudhën 1994 – korrik 1995, llogaritur në nivelin 66% të të ardhurave dhe, shpenzimet jetike të nënës së bashkëshortes, në masën 100% të vlerës së pensionit”*. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin drejtuar Kolegjit, pretendon se shpenzimet e jetesës duhet të llogariten në masën 30% të të ardhurave për të gjithë familjen, duke konsideruar se edhe të ardhurat e subjektit në ato vite si ushtarak kanë qenë të larta.
73. Trupi gjykues vlerëson se është i pabazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit se shpenzimet e jetesës duhet të konsiderohen në masën 30% për të gjithë familjen, për gjithë periudhën 1991 – 1997, në kushtet kur: a) për periudhën 1991 – 1993, ashtu siç edhe Komisioni ka konsideruar, nuk mund të krijoheshin kursime, për shkak të një realiteti të jetuar, që ka provuar se monedha zyrtare, leku, në atë periudhë pësoi një inflacion në nivel shumë të lartë e të jashtëzakonshëm¹⁹; b) nga të ardhurat e bashkëshortes dhe të prindërve të saj nga pensionet, nuk mund të konsiderohen mundësi kursimi prej 70% të të ardhurave apo shpenzime jetese prej 30%, në kushtet kur të ardhurat e tyre kanë qenë në vlerën më pak se 800 USD në vit (apo 74.240 lekë). Trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e Kolegjit se: *“Organet e rivlerësimit, sigurisht që duhet të kryejnë një analizë logjike e të arsyeshme për përlllogaritjen e këtyre shpenzimeve, në raste në të cilat ndërthuren elemente të tjera, duke mbajtur në çdo rast në konsideratë se, masa prej 66% e shpenzimeve, në raport me të ardhurat nga punësimi para vitit 2000, do të merrte kuptim vetëm kur të trajtoheshin të ardhura mesatare të sektorit publik, që shkojnë përafërsisht në vlerën rreth 800 USD në vit, sipas referencës së Bankës së Shqipërisë dhe, duke e vlerësuar këtë orientim në drejtim të përcaktimit të një analize logjike dhe jo si një referim ligjor i detyrueshëm për zbatim”*²⁰. Në rastin konkret, fakti që të dy prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit ishin pensionistë me të ardhura vjetore nën shifrën e referuar, në qëndrimin e Kolegjit, konsideruar edhe faktin se bashkëshortja me prindërit e saj kanë jetuar gjatë periudhës 1991 – tetor 1996, më së shumti, së bashku në Elbasan, ndërsa subjekti duket se ka jetuar veçmas nga janar 1994 – tetor 1996 në Korçë, mbështesin qëndrimin e mbajtur prej Komisionit se shpenzimet për jetesë të prindërve nuk mund të ishin në masën 30% të të ardhurave të tyre prej pensionit. Ndërkohë, trupi gjykues e konsideron të bazuar pretendimin se të ardhurat për periudhën kur subjekti i rivlerësimit ka pasur statusin e ushtarakut konsiderohen si të ardhura të larta dhe shpenzimet e jetesës për këtë periudhë duhet të llogariten në masën prej 30%. Për rrjedhojë, shpenzimet e jetesës për periudhën në analizë, 1991 – qershor 1995, do të rezultojnë në vlerën

¹⁹ Në raportin periodik të Bankës së Shqipërisë për vitin 1995, lidhur me ekonominë e vendit për 5 vitet e fundit, shpjegohet se: *“[...] Në shtator 1991, zhvlerësohet kursi i këmbimit zyrtar, duke u fiksuar, e, dollarin amerikan në 25 lekë/USD, nga 10 lekë/USD në fillim të vitit 1991. Më pas, zbatimi i regjimit fleksibël i kurseve të këmbimit e zhvlerësojnë monedhën vendase, lekun, në masën 220% dhe, në fund të 1992-shtit, mbyllet me një kurs këmbimi 98.88 lekë/USD. Zhvlerësimet e njëpasnjëshme në vitin 1991 u pasuan nga liberalizimi i plotë i kursit valutor të lekut në korrik 1992. Vitet 1992 dhe 1993 shënuan edhe kalimin në liberalizimin në shkallë të gjerë të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve, por duke ruajtur ende një shportë të kufizuar mallrash konsumi me çmime të kontrolluara nga shteti. Kjo periudhë shënon edhe liberalizimin e tregtisë së jashtme, duke hequr monopolin shtetëror mbi tregtinë e jashtme, dhe duke zbatuar regjime të lira importi dhe eksporti. Kursi valutor dhe çmimet e mallrave dhe shërbimeve u vunë nën sundimin e forcave të lira të tregut”*. https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime_Periodike/Raporti_Vjetor/Raporti_Vjetor_1995.html

²⁰ Sipas vendimit të Kolegjit nr. 15/2021, paragrafi 21.41.

1.487.056 lekë²¹, duke konsideruar se: a) për periudhën 1991 – 1993, nuk mund të krijohen kursime dhe, qëndron përllogaritja e Komisionit, b) për periudhën 1994 – qershor 1995, shpenzimet e jetesës prej 66% të të ardhurave për bashkëshorten, por duke i konsideruar edhe për prindërit e saj, të ardhura të cilat u korrigjuan (shtuar me + 219.754 lekë²²). Ndërsa, për periudhën korrik 1995 – tetor 1997, nga vlera e llogaritur e shpenzimeve nga Komisioni prej 487.657 lekësh, duke konsideruar shpenzime qiraje prej 95.000 lekësh²³, si dhe duke konsideruar për prindërit e bashkëshortes, ashtu si dhe për të, shpenzimet e jetesës në masën prej 66% të të ardhurave, shpenzimet e jetesës do të rezultojnë në vlerën 413.512 lekë.²⁴

74. Në konkluzion, referuar trajtimit më sipër për analizën e periudhës 1991 – tetor 1997, duke konsideruar disa nga pretendimet e subjektit të rivlerësimit, janë korrigjuar të ardhurat duke i shtuar vlerën prej + 249.603 lekësh, pra në total prej 2.732.742 lekësh, si dhe janë shtuar shpenzimet me vlerën + 109.727 lekë, por sërisht subjekti i rivlerësimit rezulton me pamundësi financiare prej – 967.826²⁵ lekësh, për të blerë, në tetor 1997, apartamentin prej 82.88 m², në Korçë. Në rast të konsiderimit të pretendimit të subjektit se për periudhën 1991 – qershor 1995, kur ka qenë ushtarak dhe të ardhurat kanë qenë të larta, shpenzimet e jetesës të llogariten ashtu si për gjyqtarët dhe prokurorët, sipas praktikës së Kolegjit, atëherë do të uleshin shpenzimet e jetesës për periudhën 1994 – qershor 1995. Duke mbajtur shpenzimet e jetesës për periudhën tjetër, ashtu si trajtuar më sipër, kursimet deri në qershor 1995, prej 373.300 lekësh, shtuar dhe kursimet e periudhës korrik 1995 – tetor 1997, prej 603.530 lekësh, në total në vlerën 976.830 lekë, përsëri nuk mbulohet me të ardhura të ligjshme blerja e apartamentit në Korçë nga bashkëshortja, për diferencën – 823.170 lekë.
75. Në përfundim, për pasurinë “apartament me sipërfaqe 82.88 m²”, në Korçë, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë plotësisht me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e pretenduara nga shitja e apartamentit në Elbasan, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e kësaj pasurie. Edhe pas konsiderimit të disa pretendimeve për të ardhura të tjera të ligjshme si dhe për shpenzimet e jetesës, përsëri subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri, për shkak të mungesës së burimeve financiare të ligjshme, ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b”, të ligjit nr. 84/2016.

²¹ Kjo vlerë rezulton si kombinim i: a) nga vlera e Komisionit prej 1.303.184 lekë, është zbritur vlera e pensionit të nënës prej 66.161 lekësh, pasi ishte konsideruar 100% shpenzime, dhe e të ardhurave të bashkëshortes prej 66% e të ardhurave 35.640 lekë, dhe rezultojnë vlera 1.213.501 lekë. Kësaj vlere i janë: b) shtuar si shpenzime jetese 100% e të ardhurave të periudhës 1991 – 1993 prej 180.381 lekësh (bashkëshortja, të ardhura 122.111 lekë, pensioni i nënës 29.135 lekë, i njëjtë konsideruar edhe për babanë e bashkëshortes së subjektit); c) shtuar edhe shpenzime jetese prej 66% e të ardhurave të periudhës 1994 – qershor 1995, prej 93.175 lekësh (bashkëshortja të ardhura 50.942 lekë; pensioni i nënës prej 45.116 lekësh, i njëjtë konsideruar edhe për babanë e bashkëshortes së subjektit).

²² Në ndryshim nga të ardhurat e periudhës, të llogaritura nga Komisioni në vlerën 1.495.946 lekë, në Kolegj rezultojnë vlera 1.715.700 lekë si kombinim i: a) shtesës së të ardhurave të bashkëshortes me 137.413 lekë, b) shtesës së të ardhurave nga pensioni prej 8.090 lekësh, c) konsideruar të ardhurat nga pensioni i babait të bashkëshortes, njësoj si i nënës prej 74.251 lekësh.

²³ Sipas shpjegimeve të subjektit në pyetësorin standard për periudhën mars 1996 – tetor 1997, bazuar në deklaratën noteriale datë 16.09.2020, bashkëlidhur pyetësorit standard, pyetja 1.

²⁴ Kjo vlerë rezulton si kombinim i: a) nga vlera e Komisionit prej 487.657 lekësh është zbritur qiraja prej 95.000 lekësh, është zbritur vlera e pensionit të nënës prej 124.722 lekësh, pasi ishte konsideruar 100% shpenzime dhe, vlera e të ardhurave të bashkëshortes prej 66% e të ardhurave 92.649 lekë dhe, rezultojnë, në konkluzion, vlera 206.787 lekë. Kësaj vlere i janë shtuar si shpenzime jetese prej 66% e të ardhurave të periudhës korrik 1995 – tetor 1997, vlera prej 206.726 lekësh (bashkëshortja të ardhura 117.381 lekë, pensioni i nënës 97.920 lekë, i konsideruar i njëjtë edhe për babanë e bashkëshortes së subjektit).

²⁵ Në ndryshim nga Komisioni që ka konkluduar në pamundësi financiare në vlerën - 1.107.701 lekë.

- Për pasurinë “apartament me sipërfaqe 120 m²”, në rrugën “{***}”, Korçë

76. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting* se apartamenti me sipërfaqe 120 m², në Korçë, është blerë me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.11.2011, dhe se si burime për blerjen e kësaj pasurie kanë shërbyer: (i) të ardhurat pas shitjes së banesës me sipërfaqe 82.88 m², në Korçë në vitin 2007, (ii) të ardhurat financiare të bashkëshortes (e pasiguruar pranë firmës “{***}” ShPK për vitin 2007 – 2008), sipas vërtetimit të lëshuar nga kjo firmë, (iii) huaja e marrë nga shtetasit G. K. dhe L. T. për shlyerjen e kështit në datën 17.03.2009, (iv) të ardhurat nga qiraja e apartamentit në Durrës, (v) kredi bankare të marrë në ProCredit Bank, në vlerën 1.000.000 lekë, (vi) Të ardhurat nga puna si pedagog, (vii) si dhe një kredi bankare në shumën 4.600.000 lekë, marrë pranë Raiffeisen Bank, me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.01.2012.
77. Në deklaratat periodike të pasurisë, lidhur me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:
- 77.1. Në deklaratën e vitit 2008: *“Pallat i ri, kam hyrë në qershor 2008. Kam paguar vetëm 1.000.000 lekë. Kjo shumë është nga vlera e shitjes së banesës së parë. Kontrata e shlyerjes së plotë të shumës është për periudhë 2-vjeçare gjatë vitit 2008 me anë të banesës në Durrës, duke e vënë në dispozicion për pushime për plazh, kam siguruar një të ardhur prej së cilës, duke i akumuluar, do të bëj të mundur shlyerjen e shumës. Gjithashtu b/shortja paguhet me një shumë lekësh për shkak se shoqëron nënën e saj për arsye kempit nga sytë (e verbër). Vlera 57.000.000 lekë. Siç u shpjegua, kam për të shlyer kështet e plota të banesës që aktualisht posedoj, 37.000.000 të vjetra”.*
- 77.2. Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2009 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Për shlyerjen e shtëpisë, kam tërhequr një kredi bankare pranë ProCredit Bank në shumën 1.000.000 lekë të reja. Këtë kredi e tërhoqëm në muajin janar 2010, përveç deklarimit të bërë për vitin 2009 të të ardhurave që siguroj për shlyerjen e shtëpisë së banimit”.*
- 77.3. Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shuma e mbetur pa likuiduar me deklarimin e vitit të kaluar, është likuiduar sipas mandatpagesave, me burim të ardhurat nga paga, 300.000 lekë të reja, me mandatpagesë datë 06.04.2011, 100.000 lekë të reja, datë 02.08.2011 dhe 100.000 lekë të reja, datë 29.10.2011.
- 77.4. Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2012, subjekti ka deklaruar se shuma e mbetur pa likuiduar me deklarimin e vitit të kaluar është likuiduar sipas mandatpagesave të dorëzuara në ILDKPKI datë 11.10.2012 dhe se ndihma e dhënë nga kunata është likuiduar në janar të vitit 2012.
78. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të përcjellë nga Drejtoria Rajonale e ASHK-së Korçë rezulton se subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar aktmarrëveshjen datë 06.04.2008, me palë shoqërinë “{***}” ShPK, për shitblerjen e një apartamenti banimi me strukturë 3+1 dhe sipërfaqe 155 m². Sipas kësaj aktmarrëveshjeje, vlera prej 5.700.000 lekësh do të shlyhej me këste dhe konkretisht: (i) pagesa e parë menjëherë, në vlerën 1.000.000 lekë; (ii) vlera e mbetur prej 4.700.000 lekësh do të shlyhej gradualisht pas 2 vitesh. Sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.11.2011, me palë bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit dhe shoqërinë “{***}” ShPK, vlera e apartamentit me sipërfaqe 120 m², rezulton të jetë 5.500.000 lekë.

79. Për këtë pasuri, Komisioni, pasi ka vlerësuar shpjegimet e subjektit të dhëna gjatë prapësimeve ndaj rezultateve të hetimit lidhur me burimet e deklaruara për krijimin e kësaj pasurie, ka çmuar se: (i) pranohet shuma e mbetur nga të ardhurat e shitjes së apartamentit me sipërfaqe 82.88 m², në Korçë në vitin 2007, në shumën 1.000.000 lekë, e deklaruar si burim për pagesën e kështit të parë; (ii) subjekti ka arritur të provojë burimin e pjesëshëm të të ardhurave të ligjshme lidhur me huan e marrë shtetasit G. K. në shumën 500.000 lekë, dhe se ai nuk arriti të provojë burimet e ligjshme të të ardhurave të shtetasit L. T. në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë; (iii) nuk pranohen të ardhurat e pretenduara nga puna si e pasiguruar e bashkëshortes pranë shoqërisë “{***}” ShPK, në shumën totale 1.500.000 lekë, të deklaruara si burim për pagesën e disa kësteve, pasi nuk u provua ekzistenca e tyre e as pagesa e detyrimeve tatimore; (iv) nuk u provua me dokumentacion ligjor ekzistenca e qirasë sezonale, shuma e të ardhurave të përfituara nga qiraja sezonale e as pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara; (v) lidhur me faktin se të ardhurat nga puna si pedagog janë përfituar në muajin korrik, ndërkohë pagesa e kështit është bërë në muajin prill e se z. Shehu ka pasur të ardhura nga paga, të cilat janë tërhequr, rezulton se duke i zbritur shpenzimet përkatëse deri në muajin prill, subjekti i rivlerësimit nuk ka mundësi të krijojë shumën 300.000 (treqind mijë) lekë për të paguar kështin në muajin prill. Në përfundim, nga analiza financiare e rishikuar në Komision, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar në pamundësi financiare për blerjen e apartamentit në vlerën - 2.800.000 lekë, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b”, të ligjit nr. 84/2016.
80. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin drejtuar Kolegjit, pretendon se në analizën financiare për mundësinë e blerjes së apartamentit, duhet të përfshihen të ardhurat e bashkëshortes nga punësimi tek “{***}” ShPK, sipas deklarimit të këtyre të ardhurave në deklaratat periodike vjetore. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendon se huaja e dhënë nga shtetasja L. T., për pagesën e kështit të tretë të apartamentit, është krijuar me burime financiare të ligjshme, dhe kërkon përfshirjen e kësaj huaje në analizën financiare. Lidhur me pagesën e kështit të pestë në shumën 200.000 lekë, dhe kështit të gjashtë në shumën prej 500.000 lekësh, gjatë vitit 2010, subjekti i rivlerësimit pretendon përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave nga dhënia me qira e apartamentit në Durrës. Lidhur me dy këstet e tjera, në shumën 500.000 lekë, të paguara gjatë vitit 2011, me burim të ardhurat nga mësimdhënia në universitet dhe të ardhurat e bashkëshortes, subjekti i rivlerësimit arsyeton se, pavarësisht se të ardhurat e deklaruara nga punësimi i tij si pedagog janë përfituar në korrik, e pagesa e kështit është bërë në prill, ai ka pasur mundësi të paguajë me të ardhura të ligjshme këstet gjatë vitit 2011 në shumën 500.000 lekë, pasi analiza e tij financiare e vitit 2011 ka rezultuar me diferencë pozitive prej + 385.575 lekësh²⁶.
81. Lidhur me burimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri, në vlerësim të pretendimeve të tij dhe të qëndrimit të Komisionit, trupi gjykues analizon dhe vlerëson si vijon:
- *Për huan e dhënë nga shtetasit G. K. dhe L. T.*
82. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *vetting*, ka deklaruar se ka paguar kështin e tretë për blerjen e apartamentit në shumën 800.000 lekë, në datën 17.03.2009, me burim: “*Hua në vlerën 1.000.000 lekë,*

²⁶ Konstatohet se subjekti në ankim ka referuar diferencën pozitive të analizës të vitit 2011, të Komisionit, ndërsa referuar analizës financiare të viteve që ka paraqitur në ankim, diferenca i ka rezultuar pozitive në vlerën + 575.131 lekë.

*marrë nga shtetasit G. K. dhe L. T., sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.02.2011”.*

83. Sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.02.2011, që subjekti i rivlerësimit e ka paraqitur bashkëlidhur deklaratës *vetting*, rezulton se shtetasit G. K. dhe L. T. deklarojnë se secili i ka dhënë subjektit të rivlerësimit, në datën 01.03.2009, shumën 500.000 lekë, e cila është dhënë jashtë zyrës noteriale. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur dhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.02.2013, ku huadhënësit deklarojnë se subjekti e ka kthyer huan e deklaruar në deklaratën noteriale të datës 25.02.2011.
84. Komisioni ka konstatuar se: (i) huadhënia në shumën 1.000.000 lekë nuk është deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2009 si burim për krijimin e kësaj pasurie; (ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e vitit 2009 as pagesën e kryer në shumën 800.000 lekë, me burim huan dhe as gjendjen *cash* në shumën 200.000 lekë si diferencë e mbetur nga përdorimi i huas; (iii) huadhënia është formalizuar me deklaratë noteriale në vitin 2011, pra 2 vjet më pas pasi ishin kryer pagesat në vitet 2009 dhe 2010; (iv) subjekti ka dhënë shpjegime kontradiktore në procesverbalet e mbajtura në ILDKPKI mbi mosdeklarimin e pagesës së vitit 2009; (v) subjekti nuk ka provuar ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të huadhënësve në vitin 2009 për shumën 1.000.000 lekë.
85. Nga verifikimi i akteve në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë hua në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, me përshkrimin: *“Me shumën e marrë kredi në vitin 2012 është likuiduar sasia e lekëve të marra hua nga unë shtetasve G. K. dhe L. T. në vitin 2009, e deklaruar nga ana ime gjatë kontrollit në ILDKPKI, në vitin 2012”.*
86. Në procesverbalin e mbajtur në datën 12.01.2012, në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar si vijon: *“Kam likuiduar në datën 17.3.2009 pranë firmës së ndërtimit këstin në shumën 800.000 (tetëqind mijë) lekë, me burim financiar hua e marra nga shtetasit G. K. dhe L. T., miq të mitë, të cilët e kanë pranuar këtë fakt me Deklaratën Noteriale të datës 25.02.2011. Se kam deklaruar pagesën e këstit në DIP-në e vitit 2009, pasi është marrë bashkëshortja me këto likuidime dhe nuk kam qenë në dijeni. Nuk e kam deklaruar marrjen e huas, pasi nuk e kisha me deklaratë noteriale dhe përsëri është neglizhenca ime”.*
87. Për huan e dhënë nga shtetasi G. K., Komisioni ka konkluduar se subjekti ka arritur të provojë burimin e pjesshëm të të ardhurave të ligjshme lidhur me huan e marrë shtetasit G. K., në shumën 500.000 lekë.
88. Për huan e dhënë nga shtetasja L. T., pjesë e huas prej 1.000.000 lekësh, Komisioni, pasi ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka bashkëlidhur dokumentacion provues në deklaratën *vetting*, lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësve, sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në pyetësorin standard dhe në pyetësorin e datës 16.11.2022, ka pyetur subjektin e rivlerësimit lidhur me burimin e të ardhurave të huadhënësës L. T. Në përgjigjet e pyetësorëve, subjekti i rivlerësimit ka depozituar si dokumente provuese: (i) Deklaratën noteriale (njohje detyrimi) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.07.2016, të shtetasit Gj. T. (bashkëshorti i shtetasës L. T.) në rolin e huadhënësit, dhe shtetasit H. Ç. në rolin e huamarrësit, të cilët kanë lëvruar shumën 125.000 euro, sipas kontratës së huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.06.2012; (ii) lëvizje të llogarisë bankare të shtetasës L. T. në Intesa

Sanpaolo Bank, si dhe lëvizjen e llogarisë së pagës së saj në Raiffeisen Bank, për periudhën 2005 – 2010.

89. Komisioni, lidhur me mundësitë financiare të shtetasës L. T. për dhënien hua të shumës 500.000 lekë, ka konstatuar se: (i) nga verifikimi lëvizjeve të llogarisë në Intesa Sanpaolo Bank rezulton se kjo shtetase ka pasur depozitë bankare në shumën 5.000 (pesë mijë) euro në datën 05.01.2009 (nuk ka të dhëna se si dhe kur është krijuar), dhe kjo shumë është tërhequr *cash* nga kjo shtetase në datën 06.04.2009, ndërkohë huaja është dhënë në datën 17.03.2009, para se të tërhiqej depozita; (ii) nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së pagës në Raiffeisen Bank të shtetasës L.T. rezulton se i ka kaluar paga mujore (pa përshkrim se nga cili institucion), për periudhën shkurt 2005 – maj 2007 në shumën totale 826.000 (tetëqind e njëzet e gjashtë mijë) lekë dhe se gjatë kësaj periudhe ajo ka paguar këste kredie në shumën 355.497 lekë me të ardhurat e pagës. Nga verifikimi i lëvizjes së llogarisë, për periudhën korrik 2007 – tetor 2007, rezulton se janë kryer depozitime *cash* në llogari nga kjo shtetase për pagesat e kredisë dhe për periudhën nëntor 2007 – dhjetor 2010 nuk ka më veprime.
90. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka informuar Komisionin se shtetasja L. T. rezulton e regjistruar në sistemin tatimor në datën 27.09.2007, si person fizik me NIPT {***}, me objekt “aktivitete juridike”, me qarkullim për vitin 2009, në shumën 700.000 lekë. Nga verifikimi i bërë nga Komisioni në sistemin *online* të Qendrës Kombëtare të Biznesit, (në vijim QKB), ka rezultuar se ky aktivitet ka qenë i pezulluar për periudhën korrik 2008 – janar 2009. ISSH-ja dhe Drejtoria e Arkivit Lundër, kanë informuar Komisionin se nuk kanë rezultuar të dhëna punësimi për shtetasen L. T. në shoqërinë / studio ligjore “{***}”.
91. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka arritur në konkluzionin se nuk provohet mundësia financiare e huadhënëses L. T. për të dhënë hua shumën 500.000 lekë në datën 17.03.2009.
92. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, duke paraqitur të njëjtat argumente si në Komision, parashtron se të ardhurat nga aktiviteti privat i huadhënëses L. T. për periudhën 2007 – 2009 janë më se të mjaftueshme për të mbuluar me burime të ligjshme dhënien e huas 500.000 lekë, pasi sipas lëvizjeve të llogarisë në Raiffeisen Bank, për periudhën 02/2005 – 05/2007, ajo ka pasur të ardhura nga pagat mujore prej 826.000 lekësh. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni duhet të kishte në konsideratë qëndrimin tashmë të konsoliduar të Kolegjit për kufijtë e shtrirjes së analizës financiare të personit tjetër të lidhur.
93. Nga verifikimi i akteve në fashikullin e Komisionit, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka sjellë bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit të datës 16.11.2022 lëvizjet e llogarisë në Raiffeisen Bank së huadhënëses L. T. për periudhën 02.03.2005 – 31.10.2010, për të cilat Komisioni ka konkluduar se: “[...] (ii) nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së pagës në Raiffeisen Bank, të shtetasës L. T., rezulton se i ka kaluar paga mujore (pa përshkrim se nga cili institucion) për periudhën shkurt 2005 – maj 2007, në shumën totale 826.000 (tetëqind e njëzet e gjashtë mijë) lekë dhe se gjatë kësaj periudhe ka paguar këste kredie në shumën 355.497 lekë me të ardhurat e pagës. Nga verifikimi i lëvizjes së llogarisë për periudhën korrik 2007 – tetor 2007, rezulton se janë kryer depozitime *cash* në llogari nga kjo shtetase për pagesat e kredisë dhe për periudhën nëntor 2007 – dhjetor 2010 nuk ka më veprime”. Sipas verifikimit të lëvizjeve të llogarisë në Raiffeisen Bank në Kolegji, është konstatuar ashtu si shprehet dhe

Komisioni dhe pretendon subjekti, se gjatë periudhës mars 2005 – maj 2007 kanë kaluar në llogarinë e personit tjetër të lidhur kreditime “paga” në total prej 826.556 lekësh, por pa përshkrim nga cili punëdhënës. Po ashtu konfirmohen dhe detajimet e Komisionit për veprimet e tjera të kryera në llogari, lidhur me kredinë e marrë nga huadhënësja dhe pagesat e kësteve të saj.

94. Nga verifikimi në Kolegj, në një vlerësim të mundësisë së kursimit nga L. T. për t’i dhënë huan prej 500.000 lekësh subjektit të rivlerësimit, referuar të ardhurave nga pagat e shpërblimet, të kaluara në llogarinë bankare, prej 826.556 lekësh për periudhën mars 2005 – maj 2007, në një përlllogaritje të thjeshtë dhe në kushtet kur nuk ka informacion të detajuar, rezulton se huadhënësja L. T. mund të kursente vlerën prej 527.382 lekësh²⁷, duke konsideruar shpenzime jetese vetëm për një person, sipas të dhënave të INSTAT, me burim ILDKPKI-në. Por, kjo analizë e thjeshtë është e paplotë në kushtet kur nuk ka informacion në fashikujt e Komisionit nëse për këto paga janë paguar detyrimet tatimore, nëse ka të ardhura të tjera nga paga, si dhe nuk ka informacion për përbërjen familjare të huadhënësës.
95. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se sipas informacionit nga DPT-ja, huadhënësja ka aktivitet të regjistruar si person fizik me objekt “aktivitete juridike” dhe se të ardhurat për vitet 2007 – 2009 janë të mjaftueshme për të mbuluar huan, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka sjellë akte lidhur me aktivitetin dhe të ardhurat e huadhënësës, por referon në shkresën kthim përgjigje të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë nr. {***} prot., datë 25.10.2022, drejtuar Komisionit. Sipas kësaj shkrese, znj. L. T. është regjistruar si person fizik me NIPT {***} në sistemin tatimor, në datën 27.09.2007, me aktivitet “*aktivitete juridike*”, dhe se për vitet 2007, 2008, nuk ka të dhëna për shkak të administrimit të tatimeve nga pushteti lokal, ndërsa në vitin 2009 ka pasur një qarkullim prej 700.000 lekësh, por nuk ka informacion për fitimin. Ashtu si dhe ka konstatuar Komisioni, nga verifikimi në sistemin *online* të QKB-së rezulton se aktiviteti me NIPT {***} ka qenë i pezulluar për periudhën korrik 2008 dhe në datën 03.12.2008 është aktivizuar përsëri. Sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, personi tjetër i lidhur, huadhënësja L. T., ka qenë me leje lindjeje në periudhën e pezullimit të aktivitetit. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar dhe se si burim për dhënien e huas kanë shërbyer të ardhurat nga marrëdhënia e punës së huadhënësës në “Studio Ligjore {***}” ShPK, me NIPT {***}, e cila sipas verifikimit nga Komisioni në sistemin *online* të QKB-së, ka rezultuar e themeluar në datën 07.03.2013, pra pas dhënies së huas.
96. Për sa analizuar më sipër, sipas të dhënave të akteve të administruara nga Komisioni, trupi gjykues çmon se qëndron konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimet e ligjshme të të ardhurave të huadhënësës L. T. në shumën 500.000 lekë, dhe se kjo hua nuk mund të ketë shërbyer si burim për pagesën e kështit të tretë prej 800.000 lekësh në datën 17.03.2009, për blerjen e apartamentit. Po ashtu, trupi gjykues çmon se qëndron dhe konkluzioni i Komisionit për mospërfshirjen në analizë të likuiditetit 200.000 lekë si *cash* në fund të vitit 2009, të mbetura nga huaja e marrë shtetasve G. K. dhe L.T., e deklaruar e përdorur në datën 09.01.2010 për pagesën e kështit të katërt të apartamentit prej 1.500.000 lekësh, për shkak se subjekti nuk e ka deklaruar pagesën e kryer në shumën 800.000 lekë dhe

²⁷ Të ardhurat e periudhës mars 2005 – maj 2007, prej 826.556 lekësh, duke zbritur shpenzimet e jetesës për një person në vlerën prej 299.175 lekësh.

as disponimin si gjendje *cash* në fund të vitit të diferencës së mbetur nga kjo pagesë në shumën 200.000 lekë, në deklaratën periodike të vitit 2009.

- *Për të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga punësimi në shoqërinë “{***}” ShPK*

97. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting*, si dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, se një nga burimet për pagesën e tri prej kësteve (kësti i dytë i datës 18.12.2008, kësti i katërt i datës 09.01.2010, dhe kësti i pestë i datës 21.03.2010), për blerjen e apartamentit, kanë qenë të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes në shoqërinë “{***}” ShPK.
98. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën periodike të vitit 2008, ka deklaruar: *“...paguar kësti i parë në shumën 1.000.000 lekë, me burim nga vlera e shitjes së banesës së parë” [...]. “Bashkëshortja në sezonin veror punon në dasma tek motra (pasi e motra ka një lokal) ku për punën që bën (si zbukuruese lokali) paguhet nga 20.000 - 40.000 lekë në varësi të kërkesave.”* Po në deklaratën e këtij viti, të bërë nga bashkëshortja e subjektit, është deklaruar: *“...likuiduar për banesën e re 20% të vlerës në shumën 2.000.000 (dy milionë) lekë”.*
99. Sipas akteve të administruara nga Komisioni, ka rezultuar se: (i) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. {***} prot., datë 05.10.2022, ka informuar Komisionin se shtetasja E. Sh. rezulton e punësuar te shoqëria “{***}” ShPK për periudhën janar 2013 – tetor 2014. (ii) ISSH-ja ka informuar Komisionin se shtetasja E. Sh. rezulton e punësuar për periudhën janar 2013 e në vijim. (iii) Nga verifikimi i lëvizjeve bankare të shtetasës E. Sh. nuk rezultojnë pagesa punësimi nga shoqëria “{***}” ShPK.
100. Subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur deklaratës *vetting*, ka sjellë në Komision një vërtetim të datës 09.12.2011, lëshuar nga shoqëria “{***}” ShPK, me administratore Z. S., motra e bashkëshortes së subjektit, në të cilin informohet se E. Sh. ka punuar me kohë të pjesshme në organizimet e aktiviteteve dhe ka përfituar të ardhura për vitet 2007 – 2010, në total prej 1.700.000 lekësh.
101. Në procesverbalin e mbajtur në datën 24.10.2012, ILDKPKI-ja ka pyetur shtetasin E. S., përfaqësues me prokurë i shoqërisë “{***}” ShPK, i cili ka deklaruar se shtetasja E. Sh. ka punuar me kohë të pjesshme në aktivitetin e motrës së saj për periudhën 2007 – 2010, për të cilën është paguar në shumat respektive, dhe në vijim ka sqaruar se: *“Nuk disponojnë dokumente për pagesat sepse kanë qenë veprimtari sezonale dhe jo të lidhura me fushën e veprimtarisë së shoqërisë “{***}” ShPK. Lokali ku është ushtruar kjo veprimtari nuk është në listën e asetëve të shoqërisë dhe ky është shkaku që nuk është evidentuar si i tillë në regjistrat e shoqërisë”.*
102. Komisioni, pasi ka vlerësuar aktet dhe shpjegimet e subjektit të dhëna gjatë prapësimeve ka konkluduar se nuk pranohen të ardhurat e pretenduara nga puna si e pasiguruar e bashkëshortes pranë shoqërisë “{***}” ShPK, të deklaruara si burim për pagesën e disa kësteve, në shumën totale 1.500.000 lekë, pasi nuk u provua ekzistenca e tyre e as pagesa e detyrimeve tatimore. Për rrjedhojë, këto të ardhura nuk janë përfshirë në analizën financiare të Komisionit për pagesën e kështit të dytë, të katërt dhe të pestë, për blerjen e apartamentit.

103. Në ankimin drejtuar Kolegjit, subjekti i rivlerësimit, me të njëjtat argumente si dhe në Komision, ka kërkuar që në analizën financiare duhet të përfshihen të ardhurat e bashkëshortes së tij nga punësimi në “{***}” ShPK, duke konsideruar rrethanat si: i) të ardhurat janë deklaruar rregullisht në deklaratat periodike vjetore dhe bazuar në nenin 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, ky deklaram përbën provë; ii) kohën mbi 11 vjet të kaluar nga realizimi të këtyre të ardhurave; iii) faktin që bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, detyrimin për mbajtjen, deklaramin e tatimin në burim e ka shoqëria / personi fizik që përfiton shërbimin. Subjekti i rivlerësimit në analizën financiare të përgjithshme që ka paraqitur në ankim, është shprehur se, edhe pse nuk ka përfshirë të ardhurat e bashkëshortes në vlerën 1.500.000 lekë nga punësimi në shoqërinë “{***}” ShPK, në vitet 2008 – 2010, ato duhet të konsiderohen në zbatim të parimit të proporcionalitetit.
104. Për sa parashtrohet subjekti i rivlerësimit, referuar dhe akteve që ai ka paraqitur në Komision, trupi gjykues vëren se vetë subjekti i rivlerësimit ka pranuar në deklaratën *vetting*, se bashkëshortja nuk ka qenë e siguruar për periudhën e punësimit pranë firmës “{***}” ShPK, për periudhën 2007 – 2008. Ky fakt rezulton dhe nga shkresa e DPT-së drejtuar Komisionit, sipas të cilës E. Sh. rezulton e punësuar te shoqëria “{***}” ShPK për periudhën janar 2013 – tetor 2014, por jo për periudhën 2008 – 2010 që i korrespondon pagesave të kësteve të apartamentit. Gjithashtu, nga aktet rezulton se nuk ka gjurmë të pagesave të përfituara nga punësimi në këtë shoqëri në llogaritë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.
105. Trupi gjykues konstaton se nuk qëndron as pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ai është në kushtet e pamundësisë objektive për sigurimin e dokumentacionit dhe të aplikimit të nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 84/2016. Nga korrespondenca e Komisionit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, nga këto institucione nuk është informuar se dokumentacioni i kërkuar nuk disponohet për shkak të dëmtimit, zhdukjes apo mosdisponimit të të dhënave të periudhës.
106. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë marrëdhënien e punësimit të bashkëshortes pranë firmës “{***}” ShPK, për periudhën 2008 – 2010, përfitimin e të ardhurave nga ky punësim apo pagimin e detyrimeve tatimore, trupi gjykues çmon se pretendimet i tij për realizimin e të ardhurave nga punësimi i bashkëshortes, mbeten në nivel deklarativ. Vetëm deklarimi në deklaratën periodike vjetore i këtyre të ardhurave të pretenduara, i pambështetur në akte të tjera të kohës, nuk mund të shërbejë për legjitimimin e tyre, apo për zbatimin e parimit të proporcionalitetit në konsiderimin e tyre siç pretendon subjekti.
107. Sa më sipër, trupi gjykues e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimet e ligjshme të të ardhurave të bashkëshortes nga punësimi në shoqërinë “{***}” ShPK, në vitet 2007 – 2010, prej 1.700.000 lekësh, të pretenduara se janë përdorur si burim për pagesat e kësteve të apartamentit në vitet 2008 dhe 2010, në vlerën prej 1.500.000 lekësh.

- Për të ardhurat nga qiraja e apartamentit në Durrës

108. Subjekti i rivlerësimit, për pagesën e kështit të gjashtë për blerjen e apartamentit ka deklaruar në deklaratën *vetting* se: “Në datën 28.8.2010 është shlyer kësti 500.000 lekë, burimi i saj është qiraja

sezonale e shtëpisë së Durrësit prej 3.000 eurosh që u konvertua në lekë. (të deklaruara këto gjatë hetimit administrativ pranë ILDKPKI 2011)”.

109. Në procesverbalin e mbajtur në datën 12.01.2012 nga ILDKPKI-ja, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Një nga këstet që kam paguar ndaj firmës së ndërtimit për blerjen e apartamentit në Korçë në vitin 2010 ka qenë shuma 3.000 euro, e përfituar nga dhënia e apartamentit në Durrës me qira; këtë shumë e kam konvertuar në lekë dhe kam shlyer detyrimin ndaj firmës”.* Në këtë procesverbal, pyetjes nëse kishte paguar detyrimet tatimore për të ardhurat nga qiraja, subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur se nuk kishte shlyer detyrimet tatimore pasi nuk kishte njohuri që kishte detyrime që rridhnin nga dhënia me qira e kësaj prone, pasi ka qenë qiradhënie sezonale. ILDKPKI-ja ka kërkuar nga subjekti vënien në dispozicion të kontratave të qiradhënies dhe në procesverbalin e mbajtur më 11.10.2012 subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se apartamenti në Durrës shfrytëzohet për qiradhënie sezonale 1-2 muaj në vit, në varësi të gjtjes së pushuesve, dhe në këto rrethana nuk janë lidhur kontrata qiraje.
110. Në përgjigjet e pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se ky apartament është lëshuar me qira ditore gjatë periudhës së verës në vitet 2007 – 2010, me çmime që varionin nga 20-30 euro/ditë, për të cilat nuk është lidhur kontratë qiraje. Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues në Komision deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.09.2020, me palë deklaruese shtetasin A. S., i cili deklaron se për periudhën e viteve 2007 – 2010 ka mbajtur çelësat e banesës së familjes së subjektit në qytetin e Durrësit dhe gjatë periudhës së verës, me lejen e tyre, është lëshuar me qira 10-12 ditë, me çmim 20-30 euro/ditë, kryesisht shtetasve kosovarë e maqedonas. Sipas deklaruesit, shumat që mblidheshin nga qiratë ia dorëzonte familjes së subjektit.
111. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 19.04.2022, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se banesa në qytetin e Durrësit i është lënë në administrim shokut të tij, A. S., dhe nëpërmjet tij është dhënë me qira për pushime ditore, dhe nga qiraja sezonale është përfituar shuma 3.000 euro, duke hequr shpenzimet për drita dhe ujë, dhe një shumë modeste për personin që e administronte.
112. Komisioni, lidhur me të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e apartamentit në Durrës për periudhën 2007 – 2010, në shumën 3.000 euro, deklaruar nga subjekti, ka konkluduar se nuk provohet dhënia me qira, po ashtu këto të ardhura nuk përmbushin kërkesat e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, për t’u konsideruar të ligjshme dhe për t’u pranuar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit duket se është në pamundësi financiare në shumën 500.000 lekë për pagesën e këstit të gjashtë me burim të ardhurat nga qiraja.
113. Duke konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka të njëjtat pretendime si në Komision, për përfshirjen në analizë të të ardhurave nga qiraja, dhe nuk ka sjellë asnjë provë të re në Kolegj, trupi gjykues vlerëson se situata faktike lidhur me këto të ardhura është e njëjtë më atë të konstatuar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit pretendon të ardhura nga qiradhënia e banesës, ndërkohë që nuk ka sjellë asnjë kontratë qiraje që t’i vërtetojë këto të ardhura, për të cilat nuk janë paguar as detyrimet tatimore referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, fakte të cilat i pranon dhe vetë në deklaratimet e tij gjatë procesit të rivlerësimit. Në këto kushte, të ardhurat e pretenduara nga qiradhënia nuk mund të konsiderohen me burime të ligjshme, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, dhe që

të kenë shërbyer si burim për pagesën e kështit të gjashtë të blerjes së apartamentit, në vlerën 500.000 lekë.

114. Subjekti i rivlerësimit, në ankim pretendon edhe se, pavarësisht përfshirjes ose jo në analizë të të ardhurave nga qiraja, ai ka pasur mundësi financiare të mbulojë me të ardhura të ligjshme kështin e pestë dhe të gjashtë të apartamentit në vitin 2010, në vlerën 700.000 lekë, pasi analiza e vitit 2010 rezulton me bilanc pozitiv. Trupi gjykues vëren se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron, pasi ai kërkon të justifikojë pagesën e kështit të gjashtë për blerjen e apartamentit, të datës 28.08.2010, me të ardhurat e vitit 2010, në kundërshtim me burimin e pagesës së deklaruar prej tij gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllimin për të justifikuar pagesën e kështit me burime të ligjshme të përfituara dhe përtej datës së pagesës së kështit.

- *Për të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga puna si pedagog*

115. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting* se ka paguar kështin e shtatë për blerjen e apartamentit në shumën 300.000 lekë, në datën 06.04.2011, me burim: “Të ardhurat si pedagog pranë Universitetit ‘Kristal’”. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, ai ka deklaruar përfitim page si pedagog në Universitetin “Kristal”, në shumën 108.000 lekë.

116. Bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentin mbi veprimet në llogarinë bankare pranë Union Bank, ku rezulton se në datën 11.07.2011, është kaluar pagesa në shumën 108.000 lekë, me përshkrimin: “*Honorare Korça tetor 2010 – janar 2011*”. Referuar mandatpagesave rezulton se shuma prej 300.000 lekësh, për pagesën e kështit të shtatë për blerjen e apartamentit, është arkëtuar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK, në datën 06.04.2011.

117. Për sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se ndërkohë që pagesa e kështit të shtatë është bërë në muajin prill, të ardhurat nga puna si pedagog janë përfituar në muajin korrik, rreth 3 muaj pasi ishte paguar shuma 300.000 lekë në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, dhe këto të ardhura nuk mund të kenë shërbyer si burim për pagesën e këtij kështi. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit duket se është në pamundësi financiare në shumën 300.000 (treqind mijë) lekë për pagesën e kështit të shtatë me burim të ardhurat e përfituara si pedagog.

118. Në ankimin drejtuar Kolegjit, subjekti i rivlerësimit parashtron se, pavarësisht se të ardhurat nga puna si pedagog janë përfituar në muajin korrik, ndërkohë që pagesa e kështit është bërë në muajin prill, ai ka pasur të ardhura të tjera nga paga të cilat mbulojnë me të ardhura të ligjshme pagesën e të gjithë shumës 500.000 lekë gjatë vitit 2011. Nga analiza financiare e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur ankimit, rezulton se analiza e vitit 2011 është pozitive me një balancë + 385.575 lekë.

119. Për sa pretendon subjekti i rivlerësimit në ankim, trupi gjykues vëren se ai nuk ka argumentuar lidhur me mospërputhjen e konstatuar nga Komisioni në deklaratimet e tij mbi burimin e pagesës së kështit të apartamentit dhe momentit të përftimit të të ardhurave si pedagog, por kërkon që të justifikojë kryerjen e pagesës me të ardhura të tjera dhe me rezultatin financiar të vitit përkatës, duke ndryshuar burimin e pagesës, në ndryshim me sa ka deklaruar në deklaratën *vetting*. Sipas kontrollit të analizës financiare të

kryer në Kolegj, edhe sikur të merret në konsideratë pretendimi i subjektit të rivlerësimit për një analizë të pjesshme deri në datën e pagesës së kështit 06.04.2011, duke marrë si burim të ardhura të tjera të përfituara deri në këtë datë, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi të krijojnë shumën 300.000 lekë për pagesën e kështit të shtatë.

120. Në përfundim të sa më sipër, dhe në kushtet e deklarimeve kontradiktore të subjektit të rivlerësimit për burimin për pagesën e kështit të shtatë të apartamentit, trupi gjykues vlerëson se mbetet i bazuar qëndrimi i Komisionit, i cili ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit duket se është në pamundësi financiare për të justifikuar burimin e deklaruar, të ardhurat e përfituara si pedagog në shumën 300.000 lekë.
121. Në konkluzion, për pasurinë “apartament me sipërfaqe 120 m²”, në Korçë, referuar ankimit të subjektit për mundësinë e blerjes së apartamentit në vlerën 5.500.000 lekë, me burimet e deklaruara, rezultoi se:
a) nuk u provuan të ardhurat me burime të ligjshme të shtetases L. T. për dhënien e huas prej 500.000 lekësh; b) nuk u provuan të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga punësimi në shoqërinë “{***}” ShPK, të cilat, ashtu si dhe Komisioni, nuk u konsideruan si të ardhura të ligjshme dhe si burim për pagesën e kësteve prej 1.500.000 lekësh; c) nuk u konsideruan si të ardhura të ligjshme të ardhurat prej 3.000 eurosh nga qiraja sezonale e apartamentit në Durrës, të deklaruara si burim për pagesën e kështit prej 500.000 lekësh në vitin 2010; d) të ardhurat e subjektit si pedagog në Universitetin Kristal, ashtu si dhe Komisioni, nuk u konsideruan si të ardhura të ligjshme pasi ishin përfituar pas pagesës së kështit prej 300.000 lekësh në datën 06.04.2011 dhe nuk mund të shërbenin si burim për pagesën e tij. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk mundi të provojë ligjshmërinë e disa prej burimeve të deklaruara për pagesat e kësteve për blerjen e kësaj pasurie, në vitet 2008 – 2011, dhe konfirmohet konkluzioni i Komisionit për pamundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit, për krijimin e pasurisë “apartament”, në Korçë, në shumën - 2.800.000 lekë, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b”, të ligjit nr. 84/2016.

- Për kredinë në Raiffeisen Bank, në shumën 4.600.000 lekë

122. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting* se, në datën 19.01.2012, ka aplikuar për marrjen e një kredie bankare në shumën 4.600.000 lekë, me afat shlyerjeje 15 vjet, e cila është tërhequr *cash* dhe është përdorur ndër vite nga subjekti si burim për shlyerje detyrimesh, krijim pasurish dhe mbulim shpenzimesh.
123. Po në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kredia, midis të tjerave, ka shërbyer si burim për krijim pasurish, konkretisht, për blerjen në vitin 2014 të pasurisë “automjet”, tip “Audi”, në shumën 650.000 lekë, dhe për blerjen në vitin 2015 të pasurisë “garazh”, në shumën 500.000 lekë, me burim të ardhurat e mbetura nga vlera e kredisë në shumën 450.000 lekë.
124. Nga verifikimi i veprimeve bankare në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në Raiffeisen Bank, Komisioni ka konstatuar se, në datën 23.1.2012, është disbursuar kredia në shumën 4.600.000 lekë, fondet e së cilës janë përdorur si vijon: (i) në datën 24.01.2012 është transferuar në llogari të subjektit në ProCredit Bank shuma 938.300 lekë për likuidimin e detyrimit total të mbetur të kredisë të marrë pranë kësaj banke; (ii) në datën 24.01.2012, subjekti ka tërhequr shumën 500.000 lekë; (iii) në datën 25.01.2012, subjekti i

rivlerësimit ka transferuar në llogarinë personale të shtetasit E. S. në Raiffeisen Bank shumën 3.130.000 lekë.

125. Komisioni, nga verifikimi i llogarisë bankare të shtetasit E. S. në Raiffeisen Bank, ka konstatuar se: (i) në datën 25.01.2012, subjekti i rivlerësimit ka transferuar në këtë llogari shumën 3.130.000 lekë, me përshkrim “kalim fondi”; (ii) në datën 26.01.2012, shtetasi E. S. ka tërhequr *cash* shumën 2.000.000 lekë; (iii) në datën 27.01.2012, shtetasi E. S. ka tërhequr *cash* shumën 600.000 lekë; (iv) në datën 27.01.2012, shtetasi E. S. ka transferuar shumën 500.000 lekë në favor të shtetases D. S. K.
126. Nga veprimet bankare në llogarinë e kredisë së subjektit të rivlerësimit, rezulton se për periudhën shkurt 2012 – mars 2018 (rreth 6 vjet), këstet mujore të kredisë (50.000 lekë në muaj) janë derdhur *cash* çdo muaj nga shtetasit E. S. dhe babai i tij Q. S.
127. Në pyetësonin nr. 3, në përgjigje të pyetjes së Komisionit mbi qëllimin e transfertës dhe marrëdhënien me shtetasin E. S., subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar *se kjo transfertë është kryer nga bashkëshortja e tij në favor të nipit E. S. për arsye të ushtrimit të aktivitetit të tij tregtar*. Ndërsa, në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar *se transferta e shumës së kredisë në favor të shtetasit E. S. nuk është deklaruar në deklaratën vetting dhe nuk gjen pasqyrim as në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, për shkak se kjo pagesë është kthyer nga z. S. për një periudhë të shkurtër kohore dhe, si e tillë, nuk është objekt deklarimi, sepse në DPV-të vjetore deklarohen detyrimet apo të drejtat, shtesat dhe pakësimet nga data 01.01 – 31.12 të çdo viti. Edhe në deklaratën vetting nuk është objekt deklarimi kalimi i fondeve vetëm për një periudhë të shkurtër. Z. S. ka pasur nevojë për likuiditet dhe për këtë arsye fondet e kredisë janë përdorur prej tij për një periudhë të shkurtër kohore. Bashkëlidhur këtij prapësimi, paraqesim edhe deklaratën e z. E. S. për marrjen dhe kthimin e shumës që i ka kaluar me transaksion bankar gjatë vitit 2012. Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka fshehur transaksionin financiar në llogarinë e shtetasit E. S., në kushtet kur shuma e dhënë hua është kthyer brenda vitit, nuk është i drejtë për shkak se ky transaksion nuk është transaksion i deklarueshëm”.*
128. Bashkëlidhur prapësimeve, subjekti i rivlerësimit ka sjellë në Komision edhe një deklaratë noteriale, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.03.2023, të shtetasit E. S., i cili deklaron se transferta e datës 25.01.2012, në shumën 3.130.000 lekë, e bërë në degën e Raiffeisen Bank nga tezja e tij, E. Sh., në emrin e tij, është përdorur për aktivitetin tregtar për likuidime *cash* për furnitorët duke qenë fillim viti, e më pas ia ka kthyer këtë vlerë tezes së tij brenda një kohe të shkurtër me këste të pjesshme.
129. Komisioni ka çmuar se subjekti i rivlerësimit, gjatë prapësimeve, nuk ka provuar me dokumentacion justifikues ligjor pretendimin e tij se ka marrë fondet mbrapsht nga z. E. S. gjatë vitit 2012, dhe se paraqitja e deklaratave noteriale të mëvonshme nuk përbën provë për Komisionin. Komisioni, në vlerësim të fakteve të rezultuara gjatë hetimit administrativ, si: (i) kalimi i fondeve të kredisë me transfertë bankare nga llogaria e subjektit në llogarinë e shtetasit E. S. në shumën 3.130.000 lekë; (ii) derdhjet *cash* të kësteve mujore të kredisë në llogari të subjektit nga shtetasi E. S. dhe babai i tij, për periudhën shkurt 2012 – mars 2018 (rreth 6 vjet), në shumën totale 3.210.000 (tre milionë e dyqind e dhjetë mijë) lekë, ka krijuar bindjen se nga fondet e kredisë, shuma 3.100.000 (tre milionë e njëqind mijë) lekë është përdorur për interesa personale të z. E. S. dhe se ajo është kthyer nga ai duke paguar

rregullisht këstet e kredisë për një periudhë 6-vjeçare. Subjekti i rivlerësimit nuk mundi të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me deklarimin e tij në deklaratën *vetting* për përdorimin e fondeve të kredisë si burim për krijimin e gjendjes *cash* në shumën 1.500.000 lekë në vitin 2012, e cila është deklaruar si burim për krijimin e pasurive të tjera të deklaruara në deklaratën *vetting*. Në analizën financiare të korrigjuar të Komisionit, shuma 3.130.000 është llogaritur si shpenzim në vitin 2012, duke mos u konsideruar si burim për krijimin e pasurive të tjera të krijuara në vijim.

130. Në ankimin drejtuar Kolegjit, subjekti i rivlerësimit parashtron se detyrimet ndaj bankës për shlyerjen e kredisë, vazhdojnë ende. Prej vitit 2016, pagat e punonjësve të Gjykatës së Korçës u kaluan në Raiffeisen Bank ShA dhe që nga ky moment pagesat për shlyerjen e kredisë kanë qenë automatike, pra menjëherë me kreditimin e pagës nga banka, në një datë të caktuar të muajit, ka transferuar automatikisht vlerën e këstit mujor. Ky fakt, sipas subjektit të rivlerësimit, vërteton tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kredia është marrë dhe është përdorur gjithmonë prej tij. Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka fshehur transaksionin financiar në llogarinë e shtetasit E. S., në kushtet kur shuma e dhënë hua është kthyer brenda vitit, nuk është i drejtë për shkak se ky transaksion nuk është transaksion i deklarueshëm. Fondet dërguar E. S. janë kthyer prej tij brenda një periudhe të shkurtër kohore dhe ky transaksion nuk përbën objekt deklarimi, sepse në deklaratat periodike vjetore deklarohen detyrimet dhe të drejtat, shtesa apo pakësime, nga data 1 janar deri në datën 31 dhjetor të çdo viti. Kolegji duhet të përllogarisë në analizën financiare të ardhurat e plota nga kredia dhe destinimin e kredisë ashtu si është deklaruar nga ankuesi në deklaratat periodike vjetore.
131. Në vlerësim të këtij shkakut ankimi, referuar akteve në fashikuj, sipas shkresës nr. {***} prot., datë 11.09.2020, së Raiffeisen Bank, dërguar Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja E. Sh. kanë nënshkruar, në datën 19.01.2012, kontratën e kredisë bankare dhe hipotekore për vlerën 4.600.000 lekë. Sipas kontratës, rezulton se kredia është kredi konsumatore, me hipotekë, me qëllim përdorimi për konsum, dhe me një pjesë të fondeve do të mbyllet kredia ekzistuese në ProCredit Bank. Si garanci hipotekore për sigurimin e kredisë është vendosur pasuria apartament banimi me sipërfaqe 120 m², në qytetin e Korçës, në rrugën “{***}”.
132. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit, rezulton se në datën 23.1.2012, është disbursuar kredia në shumën 4.600.000 lekë, fondet e së cilës janë përdorur si vijon: (i) në datën 24.1.2012, shuma 938.300 lekë është transferuar në llogari të subjektit në ProCredit Bank për likuidimin e detyrimit total të mbetur të kredisë të marrë te kjo bankë; (ii) në datën 23.01.2012, janë mbajtur komisione bankare 31.903 lekë; (iii) në datën 25.01.2012, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr shumën 500.000 lekë; (iv) në datën 25.01.2012, shuma 3.130.000 lekë është transferuar në llogarinë personale të shtetasit E. S. në Raiffeisen Bank.
133. Nga verifikimi i akteve në fashikujt e Komisionit, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar as në deklaratën *vetting* dhe as në deklaratat periodike vjetore transferimin e fondeve të kredisë prej 3.130.000 lekësh në llogarinë e E. S. Vetëm në përgjigje të pyetësorit nr. 3 subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni për qëllimin e dërgesës së fondeve të kredisë 3.130.000 lekë tek E. S., ka shpjeguar se *kjo transfertë është kryer nga bashkëshortja e tij në favor të nipit E. S. për arsye të ushtrimit të aktivitetit të tij tregtar.*

134. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratimet e tij gjatë procesit të rivlerësimit, ka pretenduar se shuma e dhënë hua nuk është deklaruar në deklaratat periodike vjetore të pasurisë pasi është kthyer brenda vitit. Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se nuk rezulton që subjekti të ketë provuar kthimin brenda vitit të kësaj shume, në *cash* apo në llogari bankare. I vetmi akt që ka sjellë subjekti i rivlerësimit për të provuar kthimin e shumës prej 3.130.000 lekësh nga shtetasi E. S. është deklarata noteriale e këtij të fundit, akt i hartuar në datën 06.03.2023, në kohën kur kishte filluar procesi i rivlerësimit ndaj subjektit dhe ai ishte njohur me rezultatet e hetimit.
135. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nga viti 2016 pagesat e kësteve të kredisë janë mbajtur nga paga e tij pas kalimit të pagës në Raiffeisen Bank, pas verifikimit të lëvizjeve të llogarisë në këtë bankë dhe për vitet në vijim, jashtë periudhës rivlerësimit, konstatohet se dhe gjatë vitit 2017 pagesat e kësteve të kredisë janë paguar me fondet e kredituara në llogarinë e subjektit nga shtetasi E. S. dhe babai i tij Q. S. Ndërsa në vitin 2018, konstatohet se vetëm dy këstet e para, të muajve janar dhe shkurt, janë paguar nga depozitimet në llogari nga babai i E. S., dhe në vijim, nga muaji mars 2018, paga e subjektit ka kaluar në Raiffeisen Bank dhe pagesat e kredisë janë mbajtur nga gjendja e fondeve në llogari që është kredituar nga pagat e subjektit dhe nga të ardhura nga qiraja.
136. Gjithashtu, referuar shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, se shtetasi E. S. e ka përdorur shumën e dhënë për aktivitetin e tij tregtar, nga lëvizjet e llogarisë bankare të këtij shtetasi evidentohet se pjesa më e madhe e shumës është tërhequr *cash* (84% e vlerës) dhe diferenca i ka kaluar një personi të tretë (vlera 500.000 lekë, transferuar znj. D. K.). Këto transaksione bien ndesh me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për përdorimin e shumës së kaluar nga kredia për qëllime të aktivitetit tregtar të shtetasit E. S. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se është i bazuar konkluzioni i Komisionit, se fondet e kredisë së marrë nga subjekti i rivlerësimit dhe të kaluara në llogarinë personale të shtetasit E. S. janë përdorur për qëllime personale të këtij të fundit. Ky fakt mbështetet dhe nga veprimet e kryera nga shtetasi E. S. dhe babai i tij për pagesën rregullisht të kësteve të kredisë për një periudhë 6-vjeçare, duke filluar nga momenti i përfitimit të saj prej subjektit të rivlerësimit. Në mbështetje të këtij dyshimi shkojnë edhe rrethanat e tjera që lidhen me mosdeklarimin e transferimit të kredisë nga subjekti, si në deklaratën *vetting* ashtu dhe në ato periodike vjetore.
137. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin drejtuar Kolegjit, lidhur me përfitimin e kredisë në Raiffeisen Bank, pretendon se në ndryshim nga analiza financiare e Komisionit, shpenzimi “përdorimi fondeve të kredisë” me përfitues shtetasin E. S., në shumën 3.100.000 lekë, nuk duhet përlllogaritur në analizën financiare si shpenzim, për shkak se kjo shumë është kthyer brenda vitit nga z. S. Për sa trajtuar më sipër, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë kthimin e shumës nga shtetasi E. S., trupi gjykues çmon se nuk qëndron pretendimi i tij për moskonsiderimin e kësaj shume si shpenzim, dhe vlerësohet, ashtu si ka konkluduar dhe Komisioni, se vlera prej 3.130.000 lekësh²⁸ duhet të jetë shpenzim, pasi nuk ka kontribuar në ekonominë familjare të subjektit, për të përballuar shpenzimet e jetesës apo për t’u konsideruar likuiditet *cash* prej 1.500.000 lekësh në fund vitit 2012, por është përdorur nga shtetasi E. S.

²⁸ Konstatohet se Komisioni ka konsideruar vlerën 3.100.000 lekë, ndërsa sipas statement-it të bankës vlera e saktë është 3.130.000 lekë (+ 30.000 lekë).

138. Në përfundim, për kredinë në Raiffeisen Bank në shumën 4.600.000 lekë, trupi gjykues, në vlerësim të fakteve se: (i) kalimi i fondeve të kredisë është kryer me transfertë bankare nga llogaria e subjektit të rivlerësimit në llogarinë e shtetasit E. S., në shumën 3.130.000 lekë; (ii) derdhjet *cash* të kësteve mujore të kredisë për llogari të subjektit janë kryer nga shtetasi E. S. dhe babai i tij, për periudhën shkurt 2012 – mars 2018, në shumën totale 3.146.400 lekë; krijon bindjen se nga fondet e kredisë, shuma 3.130.000 lekë është përdorur për interesa personale të shtetasit E. S. dhe se është kthyer nga ai duke paguar rregullisht këstet e kredisë për një periudhë 6-vjeçare. Në vlerësimin e trupit gjykues shuma 3.130.000 lekë, ashtu si ka konkluduar dhe Komisioni, duhet llogaritur në analizën financiare të subjektit si shpenzim në vitin 2012. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk mundi të provojë as përdorimin e fondeve të kredisë si burim për krijimin e gjendjes *cash* në shumën 1.500.000 lekë në vitin 2012, e cila është deklaruar si burim për krijimin e pasurive garazh, në rrugën “{***}”, Korçë, në vitin 2015, dhe automjet tip “Audi A4”, blerë në vitin 2014, duke e vendosur subjektin e rivlerësimit në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b”, të ligjit nr. 84/2016, për këto dy pasuri.

- Për pasurinë “automjet”, tip “Audi A4”, blerë në vitin 2014

139. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, në vijim të deklaramit të kredisë në Raiffeisen Bank: “[...] Nga kjo kredi më ngelën kesh në dorë në familje 1.099.797 lekë, ku shuma prej 650.000 lekësh është shpenzuar për blerjen e një makine “Audi A4” që disponoj sot, sipas kontratës {***} rep., {***} kol., datë 29.05.2014, blerë shtetasit [...]”.

140. Në deklaratën periodike të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Ndryshim për këtë vit është blerja e një makine nga shuma e deklaruar në deklaramet e viteve të kaluara, mbetur nga marrja e kredisë në shumën prej 1.100.000 lekë. Makina është blerë në shumën 650.000 lekë, e regjistruar në DRTRR Korçë në emër Besnik H. Shehu. Kontrata e blerjes së makinës është hartuar me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.05.2014, Noteri Publik F. B., Shitës është shtetasi E. B. S., përfaqësuar me prokurë nga shtetasi G. L. [...] Nga shuma totale kanë ngelur 450.000 mijë lekë”.

141. Nga informacioni i dërguar në Komision nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor rezulton se, në datën 29.05.2014, është nënshkruar kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., mes shtetases E. S., e përfaqësuar me prokurë nga shtetasi G. L. dhe blerës subjektin e rivlerësimit, kundrejt çmimit 650.000 lekë, deklaruar e likuiduar jashtë zyrës noteriale.

142. Komisioni, në rezultatet e hetimit ka konstatuar se, nisur nga burimi i deklaruar për blerjen e pasurisë automjet, deklaramet e subjektit në deklaratën *vetting* dhe në deklaramet periodike vjetore mbi disponimin *cash* të vlerës së mbetur nga kredia dhe destinacionin e përdorimit për shlyerje huaje e krijim pasurish, nuk gjejnë pasqyrim dhe nuk përputhen me veprimet bankare të kryera.

143. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij ndaj rezultateve të hetimit ka deklaruar se: “Për këtë automjet, deklaramet janë të sakta. Për burimin e krijimit, konkluzionet janë njësoj si në pikën e sipërcituar, për këtë arsye argumentet dhe provat e z. Shehu janë të njëjta edhe në këtë pikë. Viti 2004 kur është blerë ky automjet rezulton me bilanc pozitiv”.

144. Komisioni, në përfundim, ka vlerësuar se shpjegimet e subjektit nuk provojnë të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me deklarin e burimit nga fondet e mbetura të kredisë në vitin 2012, për krijimin e pasurisë “automjet”, tip “Audi”, në vitin 2014, duke rezultuar në pamundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie në shumën - 650.000 lekë.
145. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit për këtë pasuri, pasi ajo është krijuar me të ardhura të ligjshme. Subjekti i rivlerësimit pretendon se si burim për blerjen e automjetit është përdorur shuma e ngelur nga kredia e marrë në Raiffeisen Bank, shlyerja e së cilës është deklaruar rregullisht në deklaratat periodike vjetore. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit shton se viti 2014, kur është blerë automjeti, rezultoi me bilanc financiar pozitiv.
146. Lidhur me këtë shkak ankimi, ashtu si dhe trajtuar më sipër në shkakun e ankimit lidhur me kredinë në Raiffeisen Bank, kredia konsumatore me hipotekë e lëvruar më 23.01.2012, sipas lëvizjeve bankare në Raiffeisen Bank, në emër të subjektit, pjesërisht në vlerën 3.130.000 lekë, u transferua tek E. S. (nipi i bashkëshortes së subjektit), dhe nuk u provua kthimi i kësaj shume subjektit, dhe vetëm shuma prej 1.470.203 lekësh u përdor nga subjekti dhe familja e tij²⁹. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë krijimin e likuiditetit *cash* të deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2012 prej 1.500.000 lekësh, me burim nga mbetja e kredisë, pasi nga veprimet bankare nuk provohet një pretendim i tillë. Ashtu si dhe ka konstatuar dhe Komisioni, deklarin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat periodike vjetore mbi disponimin *cash* të vlerës së mbetur nga kredia, deklaruar në DPV 2012 prej 1.500.000 lekë, dhe destinacionin e përdorimit për shlyerje huaje e krijim pasurish, nuk gjejnë pasqyrim e nuk përputhen me veprimet në llogarinë bankare.
147. Sa më sipër, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk arrin të justifikojë burimin e pretenduar për blerjen e pasurisë “automjet”, tip “Audi”, në vitin 2014, ai rezultoi, ashtu si ka konkluduar dhe Komisioni, në mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, në vlerën e blerjes prej 650.000 lekësh, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b”, të ligjit nr. 84/2016.

- Për pasurinë “garazh”, në rrugën “{***}”, Korçë

148. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë “garazh”, në rrugën “{***}”, Korçë, e kontraktuar me aktmarrëveshjen e datës 27.03.2015, me palë shoqërinë “{***}” ShPK, me çmim shitjeje 500.000 lekë, i likuiduar datën e lidhjes së aktmarrëveshjes. Si burim për blerjen e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kanë shërbyer një pjesë e të ardhurave të disponuara *cash* nga kontrata e kreditimit me Raiffeisen Bank, datë 19.01.2012, në shumën 4.600.000 lekë. Sipas deklarin të subjektit të rivlerësimit, nga shuma e kredisë ka mbetur si diferencë vlere prej 1.099.797 lekësh, e cila u investua për krijimin e dy pasurive, përkatësisht blerjen e një automjeti në vitin 2014 dhe garazhin në shumën 500.000 lekë në vitin 2015.

²⁹ Sipas lëvizjeve të llogarisë bankare, si total: i) 938.300 lekë, transferuar në llogari të subjektit në ProCredit Bank, për likuidimin e detyrimit total të mbetur të kredisë; ii) 31.903 lekë, mbajtur komisione bankare, në datën 23.01.2012; iii) 500.000 lekë, tërhequr nga subjekti i rivlerësimit, në datën 25.1.2012, për pagesën e vitit të dytë dhe të tretë për studimet Bachelor të bashkëshortes.

149. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2015 aktmarrëveshjen e datës 27.03.2015, për blerjen e pasurisë “garazh me sipërfaqe 25 m²”, në shumën 500.000 lekë, e paregjistruar në ZVRPP. Si burim për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumën e mbetur nga kredia në Raiffeisen Bank, një pjesë e së cilës është përdorur për blerjen e automjetit në vitin 2014 dhe kanë mbetur 450.000 lekë, si dhe të ardhurat nga qiraja e apartamentit në Durrës.
150. Subjekti i rivlerësimi ka deklaruar në DPV-në e vitit 2012 tek sektori i detyrimeve: “...nga shlyerja e detyrimeve që kisha ndaj të tretëve, të deklaruar me deklaratën e vitit të kaluar në mbështetje të kredisë së marrë, aktualisht ka mbetur diferencë lekësh që disponoj 1.500.000 lekë dhe e administroj si familje këtë shumë”.
151. Komisioni në rezultatet e hetimit ka konstatuar se deklaratimet e subjektit në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat periodike vjetore, mbi disponimin *cash* të vlerës së mbetur nga kredia dhe destinacionin e përdorimit për shlyerje huaje e krijim pasurish, nuk gjejnë pasqyrim dhe nuk përputhen me veprimet bankare të kryera prej tij me kredinë e disbursuar në vitin 2012. Në përfundim, Komisioni për këtë pasuri ka konkluduar se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk provojnë të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me deklarimin e burimit nga fondet e mbetura të kredisë në vitin 2012 për krijimin e pasurisë “garazh”, në vitin 2015, duke rezultuar në pamundësi financiare për blerjen e pasurisë “garazh”, në muajin mars 2015, në shumën - 500.000 lekë.
152. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se kjo pasuri është krijuar me të ardhura të ligjshme, dhe se deklaratimet e tij në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat periodike vjetore mbi disponimin *cash* të vlerës së mbetur nga kredia dhe destinacionin e përdorimit për shlyerje huaje e krijim pasurish, gjejnë pasqyrim dhe përputhen me aktet e administruara gjatë hetimit administrativ. Ndërsa kalimi i fondeve në llogarinë e z. E. S. nuk tregon që kjo hua nuk është kthyer përsëri brenda vitit 2012.
153. Lidhur me shkakun e ankimit, për burimin e deklaruar për blerjen e pasurisë, nga disponimi i likuiditetit *cash* të mbetur nga kredia në Raiffeisen Bank, marrë në vitin 2012, në vijim të trajtimit më sipër në këtë vendim të shkaqeve të ankimit lidhur me këtë kredi, u konstatua se pjesa prej 3.130.000 lekësh u transferua tek E. S. (nipi i bashkëshortes së subjektit) dhe nuk u provua kthimi i kësaj shume përsëri subjektit po në vitin 2012, dhe pjesa tjetër e kredisë prej 1.470.203 lekësh u përdor nga subjekti. Ashtu si dhe ka konstatuar Komisioni, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting* dhe në deklaratën e vitit 2012 mbi disponimin *cash* të vlerës së mbetur nga kredia prej 1.500.000 lekësh, me destinacion përdorimin për shlyerje huaje e krijim pasurish, nuk gjejnë pasqyrim e nuk përputhen me veprimet në llogarinë bankare, sipas të cilave rezulton se në fund të vitit 2012 subjekti i rivlerësimit nuk mund të kishte një gjendje *cash* të mbetur nga kredia. Në këto kushte, nuk provohet as përdorimi i gjendjes *cash* të deklaruar në DPV-në e vitit 2012, e pretenduar e mbartur deri në vitin 2015, për blerjen e pasurisë “garazh”, në vlerën 500.000 lekë. Për rrjedhojë, për këtë pasuri, trupi gjykues vlerëson se është i bazuar konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit rezulton me pamundësi financiare për blerjen e pasurisë “garazh”, në datën 27.03.2015, në shumën - 500.000 lekë.

- Lidhur me përdorimin e automjetit tip “Mercedes-Benz”

154. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në pyetësorin standard se gjatë periudhës së deklarimit ka pasur në përdorim automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, në pronësi të shtetasit Q. S., baxhanaku i tij, të cilin deklaroi se e ka përdorur edhe për lëvizjet në shtetin grek. Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues kontratën e përdorimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.08.2007, me palë huadhënës shtetasin Q. S., për përdorimin e këtij automjeti pa afat. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti në deklaratën *vetting* dhe as në deklaratat periodike vjetore.
155. Lidhur me këtë pasuri, sipas akteve të administruara në Komision, rezultoi se: (i) Sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.12.2006, ky automjet është blerë nga shtetasi Q. S. kundrejt çmimit 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe sipas certifikatës së pronësisë datë 10.04.2007, ky automjet është regjistruar në pronësi të shtetasit Q. S.; (ii) Në vijim, pronësia e këtij automjeti është tjetërsuar me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.09.2014, me palë shitëse shtetasin Q. S. dhe palë blerëse shtetasin A. Gj., në çmimin 2.000 euro, paguar jashtë zyrës noteriale; (iii) Në procesverbalin e mbajtur në datën 12.1.2012 pranë ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në përgjigjen e pyetjes nr. 10 se: *“Kam në përdorim një automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, e cila është në pronësi të Q. S., baxhanakut tim. Kam investuar shumë e shitjes së automjetit të mëparshëm 350.000 lekë për blerjen e tij”*.
156. Nga verifikimi i të dhënave në sistemin TIMS, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij, për periudhën 2007 – 2013 kanë kryer 8 udhëtime jashtë shtetit me këtë automjet, ku në 7 udhëtime ai ka qenë në rolin e shoferit, dhe nuk rezultojnë të dhëna të tjera që ky automjet të jetë përdorur nga pronari, shtetasi Q. S.
157. Nga verifikimi nga Komisioni i të dhënave në sistemin AMF (TPL/karton jeshil) ka rezultuar se: (i) për periudhën 2008 – 2014, subjekti i rivlerësimit ka qenë përdorues i këtij automjeti dhe ka pasur 6 polica sigurimi në emrin e tij dhe të pronarit të automjetit; (ii) sipas të dhënave për policat e sigurimit për jashtë shtetit (kartonit jeshil), ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë përdorues në datat 01.05.2009, 03.04.2013 dhe 02.08.2013. Nga të dhënat rezultoi që pronari i automjetit, Q. S., ka pasur vetëm një policë sigurimi (kartoni jeshil) në emrin e tij, në datën 28.11.2013, për të cilën subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi përdorues, por në këtë datë, sipas sistemit TIMS, subjekti i rivlerësimit ka dalë jashtë Shqipërisë, ka qenë shofer i këtij automjeti dhe pasagjerë kanë qenë bashkëshortja dhe djali i tij.
158. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se *nuk është pronar i ligjshëm i këtij automjeti, por vetëm përdorues i tij për shkak të marrëdhënies së miqësisë dhe shoqërisë shumë të mirë me z. S. ka përdorur dhe siguruar automjetin për një periudhë të gjatë kohe. Automjeti nuk është deklaruar në DPV, sepse bazuar në ligjin nr. 9049, përdorimi i automjeteve nuk ka qenë objekt deklarimi. Të gjitha këto argumente dhe prova provojnë të kundërtën e gjetjes së njoftuar nga Komisioni.*
159. Komisioni, në përfundim ka krijuar bindjen se ky automjet ka qenë i subjektit të rivlerësimit që prej fillimit e derisa është tjetërsuar, dhe subjekti i rivlerësimit është sjellë si pronar i ligjshëm i këtij automjeti që në vitin 2007, pasi rezultoi se ai është përdorues i automjetit deri në vitin 2014, kur është tjetërsuar

pronësia, dhe se subjekti nuk ka pasur automjet tjetër në pronësi e përdorim që prej vitit 2006 deri në vitin 2014.

160. Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se nuk e ka deklaruar përdorimin e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, në deklaratat periodike vjetore, pasi përdorimi i automjeteve nuk ka qenë i detyruar për t’u deklaruar sipas ligjit nr. 9049. Subjekti pretendon se nuk është pronar i ligjshëm i këtij automjeti dhe e ka pasur në përdorim për shkak të marrëdhënieve të miqësisë me z. S., dhe nëse do të donte ta blinte këtë automjet, për shkak të vlerës së vogël të tij, i kishte mundësitë financiare, pasi analiza financiare e vitit 2007 rezulton pozitive.
161. Në shqyrtim të këtij shkakut ankimi, nga verifikimi i akteve në fashikujt e Komisionit, trupi gjykues konstaton se bashkëlidhur prapësimeve ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sjellë vërtetimin e shoqërisë “Intersig” ShA, dega Korçë, të datës 01.03.2023, sipas të cilit z. Q. S. drejtues i mjetit motorik me targë {***}, ka qenë i siguruar për përgjegjësinë ndaj palëve të treta (TPL) pranë kompanisë “INTERSIG VIG”, për periudhën 10.01.2009 – 19.03.2014. Nga shqyrtimi i këtij akti si dhe i të dhënave të AMF-së lidhur me policat e sigurimit për automjetin, për periudhën 2008 – 2014 rezultojnë 6 polica sigurimi TPL, në emrin e subjektit të rivlerësimit si përdorues, dhe të z. Q. S. si pronar.
162. Nga të dhënat e dërguara nga DPSHTRR-ja Komisionit rezulton se, për periudhën 19.08.2006 – 29.05.2014, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur një automjet në pronësi.³⁰ Në datën 01.10.2004, ai ka shitur një automjet tip “Lancia” në pronësi të tij, në vlerën 150.000 lekë, ndërsa në datën 29.05.2014, subjekti i rivlerësimit blen një automjet tip “Audi” në vlerën 650.000 lekë. Gjithashtu, nga aktet rezulton se në datën 19.08.2006, sipas kontratës së shitblerjes, subjekti ka shitur automjetin tip “Benz”, me targa {***}, në vlerën 200.000 lekë. Nga aktet rezulton se subjekti e ka deklaruar në vitin 2003 këtë automjet, të blerë në vlerën 300.000 lekë. Në procesverbalin e ILDKPKI-së, të datës 12.01.2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se e ka shitur këtë automjet në vitin 2007, në vlerën 350.000 lekë, por nuk e ka deklaruar, pasi nuk ka pasur kontratën e shitjes.
163. Në vlerësim të akteve dhe rrethanave të mësipërme, konkretisht kontratës së përdorimit, lëshimit të policave të sigurimit TPL dhe në emër të subjektit, përdorimit në udhëtimet jashtë shtetit të automjetit vetëm nga subjekti dhe familjarët e tij si dhe mospasjes së automjeteve në pronësi të subjektit për periudhën e përdorimit, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të përmbysë barrën e provës, për të shpjeguar sjelljen e tij si pronar *de facto* i kësaj pasurie, mbi të cilën është ngritur dyshimi nga Komisioni se kjo pasuri ka qenë e tij që prej fillimit e derisa është tjetërsuar.
164. Gjithashtu, lidhur me përdorimin e automjetit tip “Mercedes-Benz” konstatohet se subjekti i rivlerësimit argumenton se nuk ka pasur detyrimin ligjor për deklarim në deklaratat periodike vjetore të pasurisë. Ndërkohë, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të drejtat e përdorimit mbi automjetin as në deklaratën *vetting*, dhe për herë të parë marrëdhënien me këtë automjet e deklaroi vetëm në

³⁰ Në procesverbalin e ILDKPKI-së, të datës 12.01.2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka shitur në vitin 2007 edhe një automjet tip “Benz”, me targa {***}, në vlerën 350.000 lekë, por nuk e ka deklaruar, pasi nuk ka pasur kontratën e shitjes.

përgjigje të pyetjeve të dërguara nga Komisioni me pyetësorin standard. Bazuar në kontratën e përdorimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.08.2007, marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me automjetin, send i luajtshëm në kuptim të parashikimeve të Kodit Civil dhe të ligjit nr. 84/2016, është një marrëdhënie juridiko civile e huapërdorjes, e rregulluar shprehimisht nëpërmjet kontratës së sipërcituar, të paraqitur me cilësinë e provës në hetim prej vetë subjektit të rivlerësimit. Në analizë të këtyre veprimeve juridike, rezulton se subjekti ka fituar prej tyre të drejta përdorimi mbi automjetin, sipas parashikimeve të nenit 901 të Kodit Civil, të drejta që janë gëzuar realisht prej subjektit, sipas pohimeve të vetë atij. Neni 30 dhe shtojca nr. 2 e ligjit nr. 84/2016 i ngarkon subjektet e rivlerësimit me detyrimin për të deklaruar të drejtat e përdorimit mbi sende të paluajtshme e të luajtshme gjatë periudhës së rivlerësimit, detyrim të cilin subjekti i rivlerësimit nuk e ka përmbushur me mosdeklarimin e këtyre të drejtave në deklaratën e pasurisë *vetting*.

165. Trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi i përdorimit disavjeçar të automjetit duket se është një sjellje e qëllimshme e subjektit për të mos paraqitur me vërtetësi marrëdhëniet e tij të përdorimit, në funksion të shmangies së kontrollit nga organet e rivlerësimit të kësaj pasurive, dhe që vlerësohet në kuadër të besueshmërisë së subjektit të rivlerësimit në raport me kriterin e pasurisë.

166. Lidhur me shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, për analizën financiare, trupi gjykues, pasi kontrolloi analizën financiare të kryer në Komision, në konsideratë të konkluzioneve të mësipërme, si dhe pasi pranoi disa nga pretendimet e subjektit të rivlerësimit, konkludon se subjekti i rivlerësimit rezulton sërish me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve për periudhën në analizë, në një vlerë prej (-) 7.917.372 lekësh (472.956 lekë më pak nga konkluzioni i Komisionit), dhe gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b”, të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues arriti në këtë konkluzion pasi konstatoi se:

166.1. Për krijimin e pasurisë “apartament 126 m²”, në Durrës, sipas burimeve të deklaruara, konfirmohet përfundimi i Komisionit se personi tjetër i lidhur Zh. K. do kishte pasur mundësi të jepte hua potencialisht vetëm vlerën 13.130 USD, dhe subjekti i rivlerësimit rezulton me një diferencë negative prej - 1.374.626 lekësh për të mbuluar me burime të ligjshme krijimin e kësaj pasurie.

166.2. Për pasurinë “apartament 82.88 m²”, në Korçë, në tetor 1997, e shitur në datën 12.07.2007, për të cilën Komisioni ka konkluduar për diferencë prej - 1.107.701 lekësh sipas analizës së periudhës 1991 – tetor 1997, pas kontrollit të analizës së Komisionit në Kolegj, duke mbajtur një qasje garantiste dhe konsideruar disa pretendime të subjektit të rivlerësimit lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet e jetesës, sërish subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur rezultojnë me një diferencë negative prej - 823.170 lekësh.

166.3. Për pasurinë “apartament 120 m²”, në Korçë, konfirmohet diferenca negative e Komisionit prej - 2.800.000 lekësh për të mbuluar me burime të ligjshme krijimin e kësaj pasurie.

166.4. Për pasurinë “automjet Audi A4”, blerë në vitin 2014, Komisioni ka konkluduar për pamundësi financiare në vlerën prej - 650.000 lekësh, vlerë që konfirmohet dhe në Kolegj, pasi nuk u justifikua

burimi i deklaruar i përdorur nga fondet e mbetura të kredisë në vitin 2012, që u deklarua si burim për krijimin e likuiditetit *cash*, në fund të vitit 2012.

166.5. Për pasurinë “garazh”, në Korçë, blerë në vitin 2015, Komisioni ka konkluduar për pamundësi financiare në vlerën prej - 500.000 lekësh, vlerë që konfirmohet dhe në Kolegj.

166.6. Për krijimin e pasurive “automjet”, tip “Mercedes-Benz”, dhe ndërtimin e shtesës informale në apartamentin me sipërfaqe 82.88 m², në Korçë, si dhe për mbulimin e shpenzimeve familjare për vitin 2004, sipas kontrollit të analizës së vitit në Kolegj, rezulton një diferencë negative prej - 961.096 lekësh, diferencë më e madhe në krahasim me Komisionin prej 70.874 lekësh,³¹ e cila vjen kryesisht nga diferencat në gjendjen e likuiditeteve në bankë.

166.7. Për vitin 2012, për mbulimin e shpenzimeve familjare të deklaruara në deklaratën *vetting* dhe pagesën e huas shtetasit G. K., Komisioni ka konkluduar për diferencë negative në shumën prej - 1.067.778 lekësh. Ndërsa sipas kontrollit të analizës së vitit në Kolegj, rezulton një diferencë më e vogël në krahasim me Komisionin, prej - 808.480 lekësh.³²

167. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Besnik Shehu nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve në pikat 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 641, datë 06.04.2023, që ka vendosur caktimin e masës disiplinore të shkarkimit të tij nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

³¹ Kjo diferencë konsiston si kombinim i: i) ndryshimit të likuiditeteve në bankë, nga 356.514 lekë në 427.232 lekë, 70.718 lekë më pak se Komisioni dhe subjekti, pasi Komisioni nuk ka konsideruar balancën e llogarisë së vajzës së subjektit, M. Sh., në Raiffeisen Bank, prej 122.770 lekësh, të cilën subjekti e ka deklaruar si llogari të hapur në vitin 2000, në DPV-në e vitit 2005; ii) 156 lekë më pak se Komisioni të ardhura nga pensioni i nënës së bashkëshortes, sipas vërtetimit të ISSH-së nr. {***} prot., datë 09.09.2020, sjellë nga subjekti bashkëlidhur prapësimeve ndaj rezultateve të hetimit më datë 05.03.2023. Elementet e tjera në analizë janë konsideruar si Komisioni dhe subjekti i rivlerësimit në analizën e tij.

³² Kjo diferencë konsiston si kombinim i: i) ndryshimit të likuiditeteve në bankë, 125 lekë më shumë se Komisioni, dhe moskonsiderimit të pretendimeve të subjektit sipas trajtimeve të shkaqeve të ankimit në vendim; ii) konsiderimit të të ardhurave në vlerën 1.603.142 lekë, 13.550 lekë më pak se Komisioni për të ardhurat e nënës së bashkëshortes nga pensioni dhe nga invaliditeti, sipas akteve të sjella nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur prapësimeve. Nuk u konsideruan të ardhurat e subjektit si pedagog, pasi kanë kaluar në vitin 2013 sipas statement-it bankar, si dhe nuk u konsideruan të ardhurat e pretenduara nga subjekti për bashkëshorten (prej 105.240 lekësh) pasi nuk u provuan këto të ardhura përveç atyre si kujdestare e nënës së saj. Elementet e tjerë në analizë janë konsideruar si Komisioni dhe subjekti në analizën e tij; iii) 272.973 lekë shpenzime më pak se Komisioni, pasi janë konsideruar shpenzime jetese për nënën e bashkëshortes deri në mesin e muajit korrik 2012; vlera e dërguar pas lëvrimit të kredisë E. S. sipas statement-it të Raiffeisen Bank është 3.130.000 lekë (+ 30.000 lekë krahasuar me Komisionin); janë konsideruar dhe komisionet e kredisë si shpenzim prej 31.903 lekësh, si dhe nuk janë përfshirë këstet të cilat rezultuan të paguara nga E. S.

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 641, datë 06.04.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Besnik Shehu.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall më datë 29.10.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi